

Buletini Statistikor 2022



Përgatitur nga:
Drejtoria e Planifikimit dhe Performancës
Sektori i Informacionit të Tregut të Punës

© Copyright,
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE 2023

Përdorimi pjesor ose i plotë i të dhënave të këtij botimi,
lejohet vetëm me kushtin e citimit të plotë të burimit të informacionit.

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	3
Shkurtime e përdorura:	4
Lista e tabelave.....	5
Lista e figurave.....	6
PARATHËNIE	8
Përkufizimet dhe Metodologjia	9
TË DHËNAT KRYESORE TË TREGUT TË PUNËS	11
Kapitulli I	13
PUNËKËRKUESIT E PAPUNË TË REGJISTRUAR PRANË ZYRAVE TË PUNËS	13
I.1 Ndryshimi vjetor i regjistrit të Punëkërkuesit.....	15
I.2 Karakteristikat individuale të Pu.Pa.....	17
a. GRUPMOSHA	17
b. NIVELI ARSIMOR	18
c. GJINIA.....	19
I.3 Grupet e veçanta të Pu.Pa.-ve	20
a. Pu.Pa AFATGJATË	21
B. Pu.Pa sipas NIVELIT TË PUNËSUESHMËRISË	21
C. Pu.Pa. në PAGESË PAPUNËSIE dhe Pu.Pa. në NDIHMË EKONOMIKE	22
Ç. Pu.Pa. ROMË DHE Pu.Pa. EGJIPTIANË	23
D. Pu.Pa. ME AFTËSI TË KUFIZUAR (PAK).....	25
E. Pu.Pa. EMIGRANTË TË KTHYER.....	26
I.4 Kategoritë Profesionale të Pu.Pa-ve.....	28
Kapitulli II	32
POLITIKA E PUNËSIMIT	32
II.1 Karakteristikat e përgjithshme të biznesit.....	33
II.2 Vendet e Lira të shpallura në Zyrat e Punësimit.....	37
II.3 Lejet e Punës, Vërtetimet e Punësimit dhe Certifikatat e Regjistrimit në Punë, për të Huajt.	41
A. Leje Pune	41
B. Vërtetim deklarimi për punësim:	41
C. Certifikatë regjistrimi në punë	41
Kapitulli III	46
SHËRBIMET DHE POLITIKAT e NDJEKURA TË TREGUT TË PUNËS	46
III.1 Treguesit e monitorueshëm për vitin 2022.....	47
III.2 Punëkërkuesit e Papunë të punësuar	49
a. GJINIA.....	49
b. GRUPMOSHA	50

c. NIVELI ARSIMOR	51
d. GRUPET E VEÇANTA	52
III.3 Të dhëna për pjesëmarrësit në Programet e Nxitjes së Punësimit	54
A. SUBJEKTET PËRFITUESE	55
b. Pu.Pa - PËRFITUES	58
III.4 Të dhëna për pjesëmarrësit në Programet e Formimit Profesional	60
a. Ofruesit publik te formimit profesional	60
b. Struktura e Kursantëve	61
c. IMPLEMENTIMI I KURSIT AFTËSI DIGJITALE	68
III.5 Të dhëna për pjesëmarrësit në Programin e Pagesës së Papunësisë	69
Kapitulli IV	72
ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE DHE NJERËZORE	72
Kapitulli V	76
ARSIMI I MESËM PROFESIONAL	76
V.1 Të dhëna për regjistrimet e nxënësve për vitin shkollor 2022-2023	77
a. NXËNËS TË REGJISTRUAR	77
B. BURSAT	80
C. PRAKTIKAT PROFESIONALE	80
Ç. KALUESHMËRIA	82
V.2 Rezultatet e Gjurmimit	83

SHKURTIMET E PËRDORURA:

MFE - Ministria e Financave dhe Ekonomisë

AKPA - Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

DRAKPA - Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

DROFPP - Drejtoria Rajonale e Ofruesve të Formimit Profesional Publik

PU.PA- Punëkërkuar të Papunë

PIP-Plani Individual i Punësimit

PTP-Plani i Trajtimit të Punëdhënësit

PAK- Person me Aftësi të Kufizuar

LISTA E TABELAVE

Tab.1 Treguesit kryesorë të Tregut të punës	11
Tab.2 Treguesit kryesorë të Tregut të punës për popullsinë (15-64) vjeç, sipas Qarqeve	12
Tab.3 Ndyshimi në Stokun e papunësisë e regjistruar sipas Rajoneve.....	16
Tab.4 Struktura moshore e Pu.Pa. sipas Rajoneve (%)	17
Tab.5 Struktura arsimore e Pu.Pa. sipas Rajoneve (%)	18
Tab.6 Pu.Pa. Romë sipas Rajoneve	24
Tab.7 Pu.Pa. Egjiptianë sipas Rajoneve.....	25
Tab.8 Pu.Pa. Emigrantë të kthyer sipas Rajoneve	28
Tab.9 Pu.Pa. sipas Kategorive Profesionale	
Tab.10 Pu.Pa. të regjistruar sipas Profesioneve dhe Rajoneve	31
Tab.11 Subjektet e regjistruara në ZP (në %) sipas Rajoneve dhe tipit të pronësisë.....	34
Tab.12 Subjektet të regjistruara në ZP sipas Aktiviteteve ekonomike dhe Rajoneve	36
Tab.13 Lejet e Punës për të huajt sipas Rajoneve dhe Tipit të lejes	43
Tab.14 Vërtetimet e punësimit sipas shtetësisë Lejet e punës sipas shtetësisë	44
Tab.15 Treguesit kryesorë të performancës dhe realizimi i tyre sipas Rajoneve.....	47
Tab.16 Niveli i plotësimit të vendeve të lira sipas Rajoneve.....	48
Tab.17 Pu.Pa., të punësuar (Ndërmjetësim + G.J.P.V) sipas Grupmoshave dhe Rajoneve	51
Tab.18 Pu.Pa. të punësuar sipas Rajoneve dhe Nivelit arsimor	52
Tab.19 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim+ G.J.P.V) sipas Gjinisë dhe Grupeve të veçanta	53
Tab.20 Pu.Pa. Të punësuar (Ndërmjetësim + G.J.P.V) sipas Grupeve të veçanta dhe Rajoneve.	53
Tab.21 Të dhëna për programet e nxitjes së punësimit të zbatuara gjatë 2022	55
Tab.22 Të dhëna për pjesëmarrësit në programet e nxitjes së punësimit sipas Rajoneve dhe Gjinisë.....	55
Tab.23 Të dhëna për pjesëmarrësit në PNP sipas Programeve dhe Rajoneve.....	59
Tab.24 Pu.Pa., përfitues nga Programet e nxitjes së punësimit sipas Grupeve të veçanta	60
Tab.25 Struktura e kursantëve që përfituan pa pagesë kurse pranë DROFPP-ve	62
Tab.26 Struktura e kursantëve që përfituan me pagesë kurse pranë DROFPP- ve.....	62
Tab.27 Të dhëna për kursantët që kanë ndjekur kurset e fomimit profesional në DROFPP.....	63
Tab.28 Të dhëna për Pu.Pa. të trajnuar sipas DROFPP-ve dhe Grupeve të veçanta	63
Tab.29 Të dhëna për kursantët e trajnuar dhe çertifikuar sipas DROFPP-ve	64
Tab.30 Të dhëna për pjesëmarrësit në kurset e FP sipas statusit dhe llojit të kursit.....	66
Tab.31 Bilanci vjetor i skemës së pagesës së papunësisë	71
Tab.32 Fondi i AKPA-s sipas Programeve (Vite).....	73
Tab.34 Stafi i AKPA-s sipas Kategorive profesionale	74
Tab.35 Numri i bizneseve partnere dhe nxënësve që zhvillojnë praktikat në biznes sipas Drejtimeve.....	81

LISTA E FIGURAVE

Fig.1 Ndryshimet në shkallën e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike.....	11
Fig.2 Stoku i Pu.Pa të regjistruar gjatë 2021-2022 sipas 3-mujorëve.....	15
Fig.3 Numri i Pu.Pa. sipas Grupeve të Papunësisë	15
Fig.4 Numri i Pu.Pa të regjistruar sipas pjesëmarrjes në programe	16
Fig.5 Krahاسimi i Nr. të Pu.Pa. të regjistruar sipas Grupmoshave (2021/2022)	18
Fig.6 Krahاسimi i Nr. të Pu.Pa., të regjistruar sipas Nivelit arsimor (2021/2022)	19
Fig.7 Punëkërkues të Papunë sipas Gjinisë dhe Rajoneve	19
Fig.9 Pu.Pa. Femra sipas grupeve të veçanta	20
Fig.8 Pu.Pa. Femra sipas skemave mbështetëse me të ardhura	20
Fig.10 Pu.Pa. afatgjatë sipas periudhës së Afatgjatësisë në Papunësi	21
Fig.11 Pu.Pa. të regjistruar sipas Nivelit të punësueshmërisë dhe Rajoneve	22
Fig.13 Pu.Pa. në ndihmë ekonomike sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor	23
Fig.14 Pu.Pa. në pagesë papunësie dhe ndihmë ekonomike sipas Rajoneve.....	23
Fig.15 Pu.Pa., të regjistruar Romë sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor	24
Fig.16 Pu.Pa., të regjistruar Egjiptianë sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor	25
Fig.17 Pu.Pa. PAK të regjistruar sipas Nivelit arsimor dhe Grupmoshës.....	26
Fig.18 Pu.Pa. me Aftësi të Kufizuar, sipas Rajoneve	26
Fig.19 Pu.Pa. Emigrantë të kthyer sipas karakteristikave të kthimit	27
Fig.20 Pu.Pa. Emigrantë të kthyer sipas karakteristikave individuale	27
Fig.21 Pu.Pa. Emigrantë të kthyer sipas mbështetjes së kërkuar për riintegrim	27
Fig.22 Pu.Pa. sipas kategorive kryesore profesionale.....	29
Fig.23 Subjektet e reja të regjistruara në ZP për 2022.....	33
Fig.24 Subjektet e regjistruara si punëdhënës në ZP të licencuar për kurset e formimit profesional.....	34
Fig.25 Subjektet e regjistruara si punëdhënës në ZP sipas tipit të pronësisë.....	34
Fig.26 Subjektet e regjistruara në ZP, sipas Rajoneve.....	35
Fig.27 Subjektet e regjistruara në ZP, sipas Aktiviteteve ekonomike	35
Fig.28 Numri i subjekteve që kanë shpallur VLP dhe numri i VLP-ve të shpallura sipas Rajoneve.....	37
Fig.29 Vendet e lira të punës të shpallura, sipas Aktiviteteve ekonomike	38
Fig.30 Vendet e lira të punës sipas Rajoneve	38
Fig.31 Mënyra e sigurimit të VLP-ve	39
Fig.32 Mënyra e sigurimit të VLP-ve sipas Rajoneve.....	39
Fig.33 Vendet e lira të regjistruara në ZP sipas Aktivitete ekonomike	39
Fig.34 Vendet e lira të punës sipas Kategorive Profesionale.....	40
Fig.35 Vendet e lira të punës krahasuar me numrin e Pu.Pa.(Stoku 2022) sipas Rajoneve	40
Fig.36 Numri i të huajve të punësuar në Shqipëri sipas Rajoneve.....	42
Fig.37 Numri i të huajve të punësuar në Shqipëri sipas statusit në punësim.....	42

Fig.38 Shpërndarja e Lejeve të Punës për të huajt, sipas aktiviteteve ekonomike.....	43
Fig.39 Numri i punonjësve të huaj të pajisur me Leje pune sipas shtetësisë.....	44
Fig.40 Numri i punonjësve të huaj të pajisur me Certifikata sipas afatit	45
Fig.41 Numri i punonjësve të huaj të pajisur me Certifikata sipas shtetësisë	45
Fig.42 Numri i punonjësve të huaj të pajisur me Certifikata sipas kategorive profesionale	45
Fig.43 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim+ GJ.P.V) 2021/2022 sipas Rajoneve.....	49
Fig.44 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim+ GJ.P.V), sipas Gjinisë dhe statusit familjar	49
Fig.45 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim+ GJ.P.V) sipas Gjinisë dhe Rajoneve	50
Fig.46 Pu.Pa të punësuar (Ndërmjetësim + GJ.P.V) sipas Grupmohave	51
Fig.47 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim + GJ.P.V) sipas Nivelit arsimor	52
Fig.48 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim + GJ.P.V) 2021/2022 sipas Nivelit arsimor	52
Fig.49 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim + GJ.P.V) nga Grupet e veçanta 2021/2022	53
Fig.50 Dinamika e Fondit të Nxijtes së Punësimit, sipas Viteve (milion/lekë)	54
Fig.51 Subjektet përfituese të programeve të reja sipas aktiviteteve ekonomike.	56
Fig.52 Subjektet përfituese sipas VKM-ve dhe aktiviteteve ekonomike	57
Fig.53 Total Pu.Pa. përfitues sipas VKM-ve	58
Fig.54 Total Pu.Pa. përfitues sipas Grupmohës Fig.55 Total Pu.Pa përfitues sipas Nivelit arsimor	58
Fig.56 Numri i kursantëve sipas DROFPP-ve	61
Fig.57 Struktura e kursantëve në DROFPP	61
Fig.58 Numri i kursantëve në DROFPP sipas llojit të kurseve	62
Fig.59 Të dhëna për Pu.Pa. të trajnuar nga Grupet e veçanta	64
Fig.60 Të trajnuar sipas grupmohave dhe llojit të kurseve.....	65
Fig.61 Pjesëmarrësit në kurset e Formimit Profesional sipas llojit të kurseve	67
Fig.62 Pjesëmarrësit sipas nivelit arsimor dhe llojit të kurseve	67
Fig.63 Pjesëmarrësit në Kursin Aftësi Digjitale sipas DROFPP-ve	68
Fig.64 Fondi i pagesës së papunësisë në Vite (milion Lekë).....	69
Fig.65 Pu.Pa. të regjistruar në pagesë papunësie sipas Muajve	70
Fig.66 Pu.Pa. të regjistruar në pagesë papunësie sipas Periudhës së përfitimit	70
Fig.67 Pu.Pa të regjistruar në pagesë papunësie sipas Rajoneve dhe sektorit të ndërmarrjes.....	71
Fig.68 Pu.Pa të regjistruar në pagesë papunësie sipas Qarqeve dhe Gjinisë	71
Tab.33 Realizimi i Treguesve të Buxhetit për 2022 (000/lekë)	74
Fig.69 Stafi i AKPA (DRAKPA-t & DROFPP- të & Drejtoria Qëndrore) sipas Gjinisë.....	74
Fig.70 Shpërndarja e personelit të DRAKPA-ve dhe DROFPP- ve	75
.....	77
Fig.71 Numri i nxënësve të klasave të X të regjistruar në AP	77
Fig.72 Numri i nxënësve të regjistruar në AP sipas klasave	77
Fig.73 Nxënës të regjistruar në AP sipas shkollave	78
Fig.74 Nxënës të regjistruar në AP sipas drejtimeve	79

PARATHËNIE

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE (AKPA) prezanton për vendimmarrësit, administratorët, komunitetin e biznesit, studiuesit dhe të gjithë përdoruesit e statistikave, “Buletini Statistikor 2022”, i cili përmban të dhëna të detajuara për Tregun e punës për vitin 2022.

Statistikat e tregut të punës që siguron dhe publikon Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive japin një përshkrim të strukturës së tregut të punës bazuar në informacionin periodik të të dhënave administrative si dhe rezultatet kryesore të politikave shtetërore të punësimit si rregullatorë në këtë treg.

Qëllimi kryesor i prodhimit të statistikave të tregut të punës është marrja e një informacioni sa më të plotë mbi këtë treg dhe dinamikën e tij, si dhe për të vënë në dispozicion të politikëbërësve statistikave të duhura për hartimin e politikave të punësimit.

Të dhënat për punësimin, papunësinë, arsimin dhe formimin profesional që publikohen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), bazohen në burimet administrative dhe i referohen kryesisht:

- a. Punëkërkuesve të papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit;
- b. Punëdhënësve të regjistruar në Zyrat e Punësimit;
- c. Shërbimet që Zyrat e Punësimit ju ofrojnë punëkërkuesve dhe punëdhënësve;
- d. Kursantët që ndjekin kurset e formimit profesional pranë DROFPP-ve;
- e. Nxënësit e regjistruar në arsimin e mesëm profesional publik.

Seria kohore e të dhënave administrative të publikuara nga AKPA, nis nga 1998, (vit i krijimit) dhe ato përgatiten dhe publikohen me periodicitet 3-mujor dhe vjetor.

Një tjetër burim referues i të dhënave që publikon AKPA është Anketa e Forcave të Punës (AFP) e kryer nga INSTAT. AFP është një vërtetim statistikor që kryhet pranë familjeve dhe siguron informacion gjithëpërfshirës mbi situatën e tregut të punës. Objektivi kryesor për kryerjen e AFP është ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm të statistikave të forcave të punës sipas standardeve të EUROSTAT me qëllim mundësimin e:

- ✓ Vlerësimit sasior dhe dinamik të zhvillimeve të tregut të punës;
- ✓ Përmirësimit të statistikave mbi punësimin dhe papunësinë;
- ✓ Përmirësimit të vlerësimit të punësimit informal si pjesë e ekonomisë së pavrojtuar.

AFP u krye për herë të parë në vitin 2007 me periodicitet vjetor.

Nga tremujori i parë 2013 e në vazhdim, INSTAT publikon tregues mbi tregun e punës të vlerësuar bazuar në të dhënat e Anketës së Forcave të Punës me frekuencë 3-mujore.

PËRKUFIZIMET DHE METODOLOGJIA

POPULLSIA NË MOSHË PUNE - konsiderohen personat e popullsisë (15-64) vjeç.

Të dhënat mbi këtë kategori sigurohen nëpërmjet Censusit të Popullsisë të realizuar nga INSTAT.

FORCA E PUNËS - nënkupton popullsinë ekonomikisht aktive dhe që përcaktohet si shumatore e numrit të personave të punësuar me numrin e personave të papunë. Të dhënat mbi forcën e punës deri në vitin 2007 ishin vetëm të dhëna administrative, ndërsa pas këtij viti ato sigurohen nga AFP.

TË PUNËSUAR - konsiderohen personat që kanë kryer një punë, (qoftë dhe për 1 orë) kundrejt një page ose përfitimi, gjatë periudhës së referencës.

Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për:

1. Leje lindje, sëmundje, lëndim apo paaftësi të përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale;
2. Të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët; (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj (ose më pak) dhe personi nuk është punëtor sezonal; (b) personi merr 50% ose më shumë të pagës;
3. Të vetëpunësuar që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/ fermën/ praktikën profesionale;
4. Punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat që punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar. Ndërsa në të dhënat administrative “të punësuar” janë konsideruar të gjithë personat të cilët ndërmarrjet i deklarojnë si të tilla në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Përcaktimi i të dhënave të punësimit në Shqipëri, bëhet nëpërmjet AFP-së dhe Burimeve Administrative.

TË PAPUNË - konsiderohen personat që në javën e referencës plotësojnë këto kushte¹:

- ✓ Nuk kanë punuar (as nuk kishin një punë nga e cila munguan përkohësisht);
- ✓ Janë të gatshëm për të punuar nëse do të gjenin një punë brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës;
- ✓ Kanë kërkuar punë në mënyrë aktive gjatë periudhës katërjavore që përfundon me javën e referencës.

Burimet e informacionit për papunësinë në Shqipëri janë AFP dhe Burimet Administrative (ku papunësisë i referohemi si papunësi e regjistruar).

PUNËKËRKUES I PAPUNË I REGJISTRUAR - është çdo person me vendbanim në Shqipëri, në moshë pune, që regjistrohet si punëkërkues dhe deklaron në Zyrën

¹ Sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Punës (ILO) dhe të EUROSTAT-it.

përkatëse të punësimit që nuk është në marrëdhënie pune ose i vetëpunësuar, si dhe është i aftë dhe i gatshëm për punë.

SHKALLA E PUNËSIMIT - është raporti i të Punësuarve (15-64) vjeç kundrejt Popullsisë në moshë pune.

SHKALLA E PAPUNËSISË - është raporti i të Papunëve kundrejt Forcës së punës.

SHKALLA E PJESËMARRJES NË FORCËN E PUNËS - është raporti i Forcës së punës kundrejt Popullsisë në moshë pune.

POPULLSIA JO-EKONOMIKISHT AKTIVE - përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë, pra janë jashtë forcës së punës (nxënës/studentë, shtëpiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

TË DHËNAT KRYESORE TË TREGUT TË PUNËS

Sipas vlerësimeve nga AFP, për Grupmoshën (15-64) vjeç (3-mujori IV 2022/ 3-mujori IV 2021), rezulton se:

- **Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 74.8 %.** Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2021, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është rritur me 4.4 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm të vitit 2022, ky tregues ka pësuar një rritje prej 1.4 pikë përqindje.
- **Shkalla e punësimit është 66.5%.** Gjatë këtij tremujori, në terma vjetorë punësimi shfaq një tendencë rritje krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2021, prej 4.4%. Në terma tremujorë, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, punësimi pësoi një rritje prej 1.1 pikë përqindje.
- **Shkalla zyrtare e papunësisë është 11.0%.** Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2021, shkalla zyrtare e papunësisë pësoi një rënie prej 0.6 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e tretë 2022, shkalla zyrtare e papunësisë pësoi një rritje prej 0.2 pikë përqindje.

Tab.1 Treguesit kryesorë të Tregut të punës²

Emërtim	Tr 4/ 2021	Tr 4/ 2022
Shkalla e pjesëmarrjes në Forcën e punës	70.4	74.8
Meshkuj	77.7	80.7
Femra	63.2	69.1
Të rinjtë deri në 29 vjeç	53.9	56.8
Shkalla e Punësimit	62.1	66.5
Meshkuj	68.8	71.8
Femra	55.4	61.4
të rinjtë deri në 29 vjeç	42.8	44.6
Shkalla e Papunësisë	11.4	10.8
Meshkuj	11	10.7
Femra	11.8	11
të rinjtë deri në 29 vjeç	20.6	21.5




Fig.1 Ndryshimet në shkallën e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike

² Burimi: Anketa e Forcës së Punës INSTAT

Tab.2 Treguesit kryesorë të Tregut të punës për popullsinë (15-64) vjeç, sipas Qarqeve

Qarqet	Shkalla e Pjesëmarrjes në forcat e punës 2022	Shkalla e Punësimit 2022	Shkalla e Papunësisë 2022
Shqipëria	74.8	66.5	10.8
Berat	70,4	65,7	6,6
Dibër	59,7	48,5	18,9
Durrës	64,8	58,2	10,1
Elbasan	68,2	62,4	8,5
Fier	67,9	63,0	7,3
Gjirokastrë	65,8	64,4	2,1
Korcë	69,9	65,0	6,9
Kukës	65,8	61,3	6,9
Lezhë	58,6	44,3	24,4
Shkodër	65,5	59,3	9,4
Tiranë	58,0	50,7	12,7
Vlorë	61,0	52,3	14,2

Kapitulli I

PUNËKËRKUESIT E PAPUNË TË REGJISTRUAR PRANË ZYRAVE TË PUNËS



Në bazë të Programit Kombëtar Statistikor dhe Programit Statistikor të miratuar nga AKPA, Drejtoritë Rajonale të Punësimit mbledhin të dhëna³ mbi Punëkërkuessit e Papunë të regjistruar pranë tyre.

Në kuptim të ligjit, Punëkërkuessit e Papunë kategorizohen në këto nëngrupe:

- **Pu.Pa që përfitojnë ndihmë ekonomike** - janë personat, për të cilët është miratuar kërkesa e tyre për përfitimin e ndihmës ekonomike;
- **Pu.Pa që përfitojnë pagesë papunësie** - janë personat, për të cilët është miratuar kërkesa e tyre për përfitimin e të ardhurës nga papunësia⁴;
- **Pu.Pa të tjerë** - janë personat, të cilët nuk përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura.

Informacioni statistikor përditësohet pas çdo takimi të specialistit të Zyrës së Punës me çdo punëkërkuess të papunë dhe përpunohet duke iu referuar sistemit informatik të shërbimeve të punësimit.

Informacioni statistikor trajtuar në këtë kapitull, ka të bëjë me:

- Ndryshimet vjetore të Regjistrit të Pu.Pa-ve;
- Karakteristikat individuale të Pu.Pa-ve;
- Grupet e veçanta të Pu.Pa-ve;
- Kategoritë Profesionale të Pu.Pa-ve.

SHËNIME:

- Diferenca ndërmjet të dhënave për papunësinë të nxjerra nga AKPA, me ato të marra nga AFP, vjen për shkak se burimet e të dhënave mbulojnë grupe të ndryshme.
- AKPA, regjistron si Punëkërkuess të Papunë vetëm individët që kërkojnë punë nëpërmjet Zyrave të Punës, por jo të gjithë personat e papunë zgjedhin ta bëjnë këtë.
- Të dhënat e AFP janë më gjithëpërfshirëse duke qenë të projektuara për të përfshirë të gjithë individët që kërkojnë punë aktivisht dhe që janë të gatshëm të punojnë dhe jo vetëm ata që janë regjistruar pranë AKPA.
- Sipas AFP shumica e të papunëve u drejtohen të afërmeve apo miqve/ shokëve për të gjetur një punë. Të papunët që kërkojnë punë nëpërmjet Zyrave të Punësimit përbëjnë rreth 50% të Totalit të papunëve.

³Regjistrimi bëhet në bazë të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Nenit 8 të Ligjit nr. 146/2015, dt. 17. 12. 2015, "Për punëkërkuessit".

⁴ Sipas ligjit nr. 7703, dt. 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

I.1 Ndryshimi vjetor i regjistrit të Punëkërkuesit

Sipas të dhënave të burimeve administrative, rezulton se në Tr.4 2022, rezultonin të regjistruar pranë Zyra të Punësimit **79,517** Punëkërkues të Papunë nga **70,646** që ishin në fund të vitit 2021. Në 2021 AKPA nisi përdorimin e sistemit të përmirësuar të shërbimeve të punësimit. Ky proces nisi me transferimin e databazës së Pu.Pa-ve nga sistemi i vjetër në sistemin e përmirësuar në muajin Prill 2021. Gjatë pjesës së mbetur të 2021 specialistët e ZP vijuan me procesin e rikontaktimit, riintervistimit dhe hartimit të Planit Individual të Punësimit (PIP) për çdo Pu.Pa. Fillimisht rikontaktimi i Pu.Pa-ve nisi nga kategoria e parë dhe e dytë e punësueshmërisë si dhe nga kategoria e NE. Rikontaktimi i kategorive të tjera vulnerabël nisi në fund të vitit 2021.

Si rezultat i këtij procesi numri i Pu.Pa-ve i cili ishte mbi 90 mijë të regjistruar në momentin e transferimit të të dhënave nga sistemi i vjetër, pas rikontaktimit, në tremujorin e fundit të vitit 2021 u reflektua me një rënie prej gati 28%.

Gjatë 2022 regjistri i punëkërkuesve të papunë u karakterizua nga një rritje e lehtë dhe e qëndrueshme prej 2-3 % për cdo tremujor. Në Fig.2 pasqyrohet efekti në regjistrin e Pu.Pa-ve gjatë gjithë ecurisë së këtij procesi.




Fig.2 Stoku i Pu.Pa të regjistruar gjatë 2021-2022 sipas 3-mujorëve




Fig.3 Numri i Pu.Pa. sipas Grupeve të Papunësisë

Pavarësisht rritjes së numrit total të punëkërkuesve të papunë nga tremujori i parë i vitit në tremujorin e katërt (i cili kryesisht ka ardhur si pasojë e orientimit të të rinjve për t'u regjistruar në zyrat e punës si një masë paraprake për pilotimin e programit të garancisë rinore) vihet re një ulje e numrit të të papunëve të regjistruar pjesë e grupeve të mbështetjes me të ardhura, dhe kjo shpjegohet me zhvillimet pozitive të tregut të punës si dhe me politikën ndërinstitucionale të integritit të të papunëve pjesë e ndihmës ekonomike në tregun e punës.

Tab.3 Ndyshimi në Stokun e papunësisë e regjistruar sipas Rajoneve

Rajonet	Stoku 2021	Stoku 2022	Diferenca e Stokut në %
Berat	2,539	2,212	-13%
Dibër	5,319	4,819	-9%
Durrës	7,309	5,887	-19%
Elbasan	9,903	9,609	-3%
Fier	11,052	6,895	-38%
Gjirokastrë	4,831	5,117	6%
Korçë	6,177	6,249	1%
Kukës	7,048	6,436	-9%
Lezhë	3,449	3,574	4%
Shkodër	8,186	5,700	-30%
Tiranë	15,056	15,807	5%
Vlorë	6,550	4,574	-30%
Total	87,419	76,879	-12%

Pavarësisht procesit të përditësimit të regjistrit dhe çregjistrimeve nga pjesëmarrja në programe, stoku vjetor i papunësisë së regjistruar gjatë 2021 mbeti në nivele të larta.

Pavarësisht rritjes së qëndrueshme të regjistrit të papunësisë gjatë 2022, stoku vjetor rezultoi -12% krahasuar me një vit më parë. Kjo rënie reflektohet në pjesën më të madhe të rajoneve. Rajonet të cilat rezultojnë me rënie të nivelit të stokut janë Fieri, Shkodra dhe Vlora përkatësisht me -38%, -30% dhe -30%.

Në Rajonin e Gjirokastrës, Tiranës dhe Lezhës stoku i papunësisë së regjistruar rezultoi me rritje përkatësisht 6%, 5% dhe 4%.




Fig.4 Numri i Pu.Pa të çregjistruar sipas pjesëmarrjes në programe

Duke ju referuar grafikut të mësipërm vihet re se çregjistrimet me arsye punësimit rezultojnë me një rritje prej 12% krahasuar me vitin 2021. Numri i pjesëmarrësve në PNP- të e reja gjatë vitit 2022 rezultoi të jetë 31% më shumë se realizimi i vitit të kaluar. Ky rezultat është rrjedhojë e nisjes së zbatimit të programeve të reja në fillimit të 2022 duke vijuar të hapura gjatë gjithë vitit.

I.2 Karakteristikat individuale të Pu.Pa.

A. GRUPMOSHA

Mosha e Pu.Pa. është grupuar në 8 intervale, secili me diapazon 5 vjeçar. Vlen për t'u theksuar se **58%** të Pu.Pa. të regjistruar, janë të grupmoshës mbi 40 vjeç. Numri i të rinjve të grupmoshës 15- 29 vjeç përbën vetëm 23% të regjistrit të punëkërkuar.

Krahasuar me nivelin kombëtar:

- Rajonet Berat, Elbasan, Fier, Lezhë dhe Tiranë rezultojnë me nivelin më të lartë të Pu.Pa-ve të regjistruar nga grupmosha mbi 40 vjeç
- Rajonet Berat, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër dhe Vlorë rezultojnë me nivelin më të lartë të Pu.Pa-ve të regjistruar nga grupmosha mbi 15-29 vjeç.

Tab.4 Struktura moshore e Pu.Pa. sipas Rajoneve (%)

Rajonet	15 - 19 vjeç	20 - 24 vjeç	25 - 29 vjeç	30 - 34 vjeç	35 - 39 vjeç	40 - 44 vjeç	45 - 50 vjeç	mbi 50 vjeç
Berat	4.9	11.0	7.3	7.6	7.2	7.2	11.1	43.7
Dibër	1.1	10.6	10.7	10.7	12.3	11.2	17.4	25.9
Durrës	4.8	13.1	9.4	8.2	8.5	7.8	12.6	35.7
Elbasan	1.1	8.1	8.5	9.3	10.7	11.0	16.5	34.9
Fier	2.3	9.3	8.8	8.7	8.9	9.4	14.4	38.0
Gjirokastrë	2.7	11.6	9.6	10.7	11.0	9.7	13.2	31.6
Korçë	1.3	10.6	13.8	10.8	9.7	9.0	12.1	32.7
Kukës	1.1	11.4	11.9	10.0	10.7	11.7	16.1	27.1
Lezhë	1.2	7.8	7.3	7.8	8.7	10.5	12.6	44.0
Shkodër	2.9	13.6	11.1	8.7	7.8	7.8	12.3	35.8
Tiranë	4.5	10.2	8.2	8.3	10.6	10.1	14.0	34.1
Vlorë	2.4	12.3	9.5	8.9	9.7	9.3	13.3	34.7
Total	2.6	10.6	9.6	9.1	9.9	9.8	14.1	34.2

Krahasuar Stokun e papunësisë të një viti më parë, numri total i Pu.Pa-ve të regjistruar ka rënë me -12%. Kjo rënie reflektohet në të gjitha kategoritë e grupmoshave.




Fig.5 Krahësimi i Nr. të Pu.Pa. të regjistruar sipas Grupmoshave (2021/2022)

B. NIVELI ARSIMOR

Arsimimi i të Papunëve klasifikohet në 6 nivele:

Më pak se Arsimi Fillor; Arsimi Fillor; Arsimi bazë 9-vjeçar; Gjinnaz; E Mesme Profesionale dhe Arsimi i Lartë.

Vlen për të theksuar se Pu.Pa., me arsim deri në 9-vjeçar përbëjnë 54.7% të Totalit të atyre të regjistruar. Numri i Pu.Pa-ve me arsim të mesëm ose të lartë përbën 45.3% të regjistrit të punëkërkuës.

Krahësuar me nivelin kombëtar:

- Rajonet Dibër, Durrës, Elbasan, Fier dhe Lezhë rezultojnë me nivelin më të lartë të Pu.Pa-ve të regjistruar me arsim deri 9-vjeçar.
- Rajonet Berat, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë rezultojnë me nivelin më të lartë të Pu.Pa-ve të regjistruar me arsim të mesëm ose të lartë.

Rajonet	Më pak se Arsimi Fillor	Arsimi Fillor	Arsimi Bazë	Gjinnaz.	E mesme profesionale	Arsimi i Lartë
Berat	2.1	3.2	48.8	22.1	15.9	7.9
Dibër	1.0	2.9	51.9	31.5	5.4	7.3
Durrës	4.3	2.6	48.3	29.2	6.1	9.6
Elbasan	6.2	6.5	53.2	18.6	8.6	6.9
Fier	4.6	2.5	49.6	26.8	8.8	7.6
Gjirokastrë	3.6	1.7	44.4	36.9	3.9	9.4
Korçë	3.8	6.0	40.1	31.8	7.8	10.6
Kukës	0.5	1.2	47.1	39.3	3.9	8.0
Lezhë	3.6	3.2	52.7	29.2	5.9	5.4
Shkodër	1.0	1.6	50.3	31.4	5.1	10.7
Tiranë	4.4	4.6	43.4	30.4	7.1	10.1
Vlorë	5.5	2.7	45.8	30.4	4.4	11.2
Total	3.7	3.6	47.4	29.7	6.7	8.9

Tab.5 Struktura arsimore e Pu.Pa. sipas Rajoneve (%)

Rënia e numrit mesatar vjetor (Stoku) të punëkërkuesve të papunë të regjistruar gjatë vitit 2022, me -12% më pak se një vit më parë, u reflektua në të gjitha kategoritë arsimore.




Fig.6 Krahasoni i Nr. të Pu.Pa., të regjistruar sipas Nivelit arsimor (2021/2022)

C. GJINIA

Gjatë vitit 2022, rezulton se janë regjistruar **40,620** Punëkërkuese të Papuna Gra (stoku/ mesatarja vjetore), ose **53%** e Totalit.

Krahason me nivelin kombëtar, rajonet Dibër, Durrës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë rezultojnë me nivelin më të lartë të Pu.Pa-ve gra të regjistruara përkatësisht me 55%, 56%, 56%, 54%, 55% dhe 55%.




Fig.7 Punëkërkues të Papunë sipas Gjinisë dhe Rajoneve

Gjatë vitit 2022, rezulton se 35% e Pu.Pa-ve Gra, përfitonin nga skemat mbështetëse me të ardhura. Gjithashtu, pjesëmarrja e grave në grupet vulnerabël është nën 53% të Totalit, me përjashtim të pagesës së papunësisë ku rreth 60% e përfituesve janë gra.




Fig.8 Pu.Pa. Femra sipas skemave mbështetëse me të ardhura




Fig.9 Pu.Pa. Femra sipas grupeve të veçanta

I.3 Grupet e veçanta të Pu.Pa.-ve

Kategorizimi i “Grupeve të veçanta” të punëkërkuesve të papunë të disavantazhuar në Tregun e punës, i realizuar sipas përcaktimeve ligjore⁵ përfshin individët:

- a. Individët me statusin e jetimit që ndodhen në kushte të vështira ekonomike;
- b. Kryefamiljarë të vetëm me fëmijë në ngarkim;
- c. Persona me aftësi të kufizuar;
- d. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- e. Persona me moshë mbi 55 vjeç;
- f. Persona nga komuniteti Rom dhe Egjiptian;
- g. Persona që kanë vuajtur dënimin me burgim;
- h. Persona nga familje që përfitojnë nga Programet e mbështetjes me të ardhura, (personat përfitues të ndihmës ekonomike, individualisht apo si pjesëtarë të familjes në Ndihmë Ekonomike (Dr.Pol.Soc.);
- i. Punëkërkues të Papunë afatgjatë (të regjistruar si punëkërkues të papunë prej më shumë se një viti);
- j. Punëkërkues të Papunë të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni;
- k. Të mitur dhe të rinj në konflikt me ligjin;
- l. Të rinjtë me moshë nën 29 vjeç;
- m. Viktimat e trafikut dhe të dhunës me bazë gjinore dhe në familje;
- n. Nënata nën moshën 18 vjeç.

Sipas këtij ligji, këto kategori kanë përparësi në përfshirjen në të gjitha politikat aktive shtetërore që zbaton AKPA. Pjesa më e madhe e tyre trajtohen në Nivelin e III-të të shërbimeve të punësimit me këshillim të individualizuar.

Në vijim të dhënat specifike për çdo grup:

⁵Ligji Nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"

A. PU.PA AFATGJATË

Një Punëkërkuës i Papunë kategorizohet afatgjatë, nëse ka mbi 1 vit i regjistruar si Punëkërkuës i Papunë në Zyrën e Punës. Përqindja që zënë të papunët afatgjatë ndaj Totalit të papunëve të regjistruar është një nga indikatorët e rëndësishëm të Tregut të punës.

Në fund të vitit 2021, rezultojnë të regjistruar si Pu.Pa afatgjatë **33,769** individë. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten Pu.Pa -t e kategorizuar sipas afatgjatësisë.




Fig.10 Pu.Pa. afatgjatë sipas periudhës së Afatgjatësisë në Papunësi

B. PU.PA SIPAS NIVELIT TË PUNËSUESHMËRISË

Me zbatimin e e sistemit të përmirësuar të shërbimeve të punësimit nisi mbledhja e të dhënave statistikore të Pu.Pa duke rritur numrin e treguesve të disagregueshëm. Një prej treguesve të rinj të mbledhur ishte edhe niveli i punësueshmërisë.

Gjatë vitit 2022 rezultoi se vetëm **5%** e regjistrit të Pu.Pa-ve të regjistruar ishin në nivelin e parë të punësueshmërisë (më afër riintegrit në tregun e punës), **47%** në nivelin e dytë dhe **48%** në nivelin e tretë të punësueshmërisë. Niveli i tretë përfaqëson kategorinë më të vështirë të Pu.Pa-ve të regjistruar të cilët rezultojnë me pengesa të shumta për punësueshmërinë e tyre. Këto të dhëna ndërlidhen dhe me nivelin e arsimit të punëkërkuësve i cili është një ndër faktorët e rëndësishëm në formulën ekonometrike të përcaktimit të nivelit të punësueshmërisë.

Krahasuar me nivelin kombëtar Rajonet Elbasan, Dibër, Tiranë dhe Berat rezultojnë me nivelin më të lartë të Pu.Pa-ve të regjistruar në nivelin e tretë të punësueshmërisë përkatësisht me **63%**, **55%**, **52%** dhe **51%**.




Fig.11 Pu.Pa. të regjistruar sipas Nivelit të punësueshmërisë dhe Rajoneve

C. PU.PA. NË PAGESË PAPUNËSIE DHE PU.PA. NË NDIHMË EKONOMIKE

Gjatë vitit 2022, **2,586** Pu.Pa. rezultojnë në pagesë papunësie (3% e Totalit) dhe **27,451** Pu.Pa. janë përfitues të ndihmës ekonomike (36% e Totalit).

Nga totali i Pu.Pa. në pagesë rreth **60%** janë Gra dhe **40%** Kryefamiljarë, ndërsa nga totali i Pu.Pa në ndihmë ekonomike **48%** janë Gra dhe **43%** Kryefamiljarë.

Nga grafikët në vijim vihet re se **73%** e Pu.Pa. në pagesë papunësie janë mbi 40 vjeç dhe **61%** janë me arsim të mesëm, profesional dhe të lartë.

Rreth **61%** e Pu.Pa-ve në ndihmë ekonomike janë mbi 40 vjeç, dhe **73%** janë me arsim deri 9-vjeçar.




Fig.12 Pu.Pa. në pagesë papunësie sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor




Fig.13 Pu.Pa. në ndihmë ekonomike sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor




Fig.14 Pu.Pa. në pagesë papunësie dhe ndihmë ekonomike sipas Rajoneve

Ç. PU.PA. ROMË DHE PU.PA. EGJIPTIANË

Gjatë vitit 2022, rezultonin të regjistruar si Pu.Pa. **2,842** individë nga kategoria Romë, (**4 %** e Totalit) dhe **4,357** individë nga kategoria Egjiptianë, (**6%** e Totalit).

Nga totali i Pu.Pa. Romë **49%** janë Gra dhe **43%** Kryefamiljarë, ndërsa nga totali i Pu.Pa Egjiptianë **50%** janë Gra dhe **47%** Kryefamiljarë.

AKPA monitoron përfshirjen e kësaj kategorie në politikat aktive të tregut të punës në përputhje me Indikatorët e Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025.

Vështirësitë për integrimin në tregun e punës përveç llojit të kategorisë dhe numrit të ulët të të regjistruarve në ZP janë moshë, arsimi dhe mungesa e një profesioni.

Punëkërkuessit e papunë të regjistruar nga këto kategori janë të një moshe relativisht të re, përkatësisht **69%** e Romëve dhe **56%** e Egjiptianëve janë të moshës 15-44 vjeç. Pjesa më problematike e kësaj kategorie është arsimi. Rreth **66%** e Romëve dhe **35%** e Egjiptianëve janë pa arsim, ose me arsim fillor, çka e bën shumë të vështirë punësimin dhe dërgimin e tyre në formim profesional.

Mungesa e arsimit reflektohet edhe në aftësitë e këtyre punëkërkuessve. Rreth **49%** e Romëve dhe **43%** e Egjiptianëve kategorizohen pa profesion ose me profesione tepër elementare.

Pavarësisht vështirësisë së këtij grupi për integrimin në tregun e gjatë vitit 2022 kjo kategori ka qenë në fokus për përfshirjen në çdo program apo shërbim që është ofruar.




Fig.15 Pu.Pa., të regjistruar Romë sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor

Tab.6 Pu.Pa. Romë sipas Rajoneve

Rajonet	Total	prej tyre në % ndaj Totalit	
		Femra	Kryefamiljarë
Berat	65	50.7	56.2
Dibër	110	39.8	41.6
Durrës	282	52.4	45.7
Elbasan	537	46.5	43.3
Fier	397	46.4	42.5
Gjirokastrë	211	48.8	30.5
Korçë	359	48.8	46.6
Kukës	40	59.0	12.8
Lezhë	53	56.1	35.1
Shkodër	25	54.5	54.5
Tiranë	547	51.3	46.9
Vlorë	216	46.9	39.5
Total	2,842	49.0	43.4




Fig.16 Pu.Pa., të regjistruar Egjiptianë sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor

Tab.7 Pu.Pa. Egjiptianë sipas Rajoneve

Rajonet	Gjithsej	prej tyre në % ndaj Totalit	
		Femra	Kryefamiljarë
Berat	207	47.5	56.0
Dibër	110	48.6	43.9
Durrës	279	54.6	43.1
Elbasan	1633	48.1	45.7
Fier	178	47.4	46.8
Gjirokastrë	227	41.4	46.4
Korçë	691	47.7	49.9
Kukës	59	51.7	34.5
Lezhë	214	50.9	49.5
Shkodër	135	50.8	46.9
Tiranë	421	56.6	46.2
Vlorë	203	55.1	39.9
Total	4357	49.5	46.5

D. PU.PA. ME AFTËSI TË KUFIZUAR (PAK)

Gjatë vitit 2022, rezultojnë të regjistruar si Pu.Pa., nga kjo kategori **237** individë, nga **475** që rezultojnë një vit më parë. Ulja e stokut reflektoi ecurinë e procesit të rikontaktimit dhe përditësimit të të dhënave për kategorinë PAK. Ky proces nisi në fund të 2021 dhe vijoi në 6 mujin e parë të 2022 duke ulur ndjeshëm numrin e të regjistruarve në këtë kategori. Gjatë periudhës Korrik- Dhjetor 2022 zyrtarët e punësimit në bashkëpunim me SHSSH nisën regjistrimet e reja të Pu.Pa –ve nga kjo kategori. Si rezultat stoku i 3 mujit të 4 të vitit 2022 rezultoi me 437 të regjistruar ose 4 herë më i lartë se 6 muji i parë i po të njëjtit vit.

Në ligjin e nxitjes së punësimit, personat me aftësi të kufizuara janë grup i synuar për përfshirjen në të gjitha Programet shtetërore të nxitjes së punësimit dhe formimit profesional.

Gjithashtu, AKPA monitoron përfshirjen e kësaj kategorie në politikat aktive të tregut të punës në përputhje me Indikatorët e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të kufizuara 2021-2025

Nga totali i Pu.Pa me aftësi të kufizuara që rezultojnë të regjistruar gjatë 2022, **38%** janë Gra dhe **36%** Kryefamiljarë.




Fig.17 Pu.Pa. PAK të regjistruar sipas Nivelit arsimor dhe Grupmoshës




Fig.18 Pu.Pa. me Aftësi të Kufizuar, sipas Rajoneve

E. PU.PA. EMIGRANTË TË KTHYER

Të dhënat për Emigrantët e kthyer i përkasin Punëkërkuesve të Papunë të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni.

Gjatë vitit 2022, rezultojnë të regjistruar në Zyrat e Punësimit **360** emigrantë të kthyer, prej të cilëve 9% janë regjistrime të reja të vitit 2022.




Fig.19 Pu.Pa. Emigrantë të kthyer sipas karakteristikave të kthimit




Fig.20 Pu.Pa. Emigrantë të kthyer sipas karakteristikave individuale




Fig.21 Pu.Pa. Emigrantë të kthyer sipas mbështetjes së kërkuar për riintegrim

Tab.8 Pu.Pa. Emigrantë të kthyer sipas Rajoneve

Rajonet	Gjithsej	deri në 29 vjeç	30 - 39 vjeç	mbi 40 vjeç	deri në 9 vjeçar	Mesme	Universitare
Berat	42	4.8	0.0	95.2	45.2	42.9	11.9
Dibër	12	25.0	16.7	58.3	83.3	16.7	0.0
Durrës	19	4.5	22.7	72.7	68.2	31.8	0.0
Elbasan	61	33.3	33.3	33.3	77.1	18.8	4.2
Fier	30	0.0	6.5	93.5	58.1	38.7	3.2
Gjirokastrë	15	0.0	13.3	86.7	33.3	53.3	13.3
Korçë	17	9.5	4.8	85.7	57.1	33.3	9.5
Kukës	47	17.4	21.7	60.9	56.5	41.3	2.2
Lezhë	12	6.7	0.0	93.3	53.3	40.0	6.7
Shkodër	31	13.5	24.3	62.2	48.6	32.4	18.9
Tiranë	64	32.8	35.8	31.3	40.3	43.3	16.4
Vlorë	10	18.2	0.0	81.8	72.7	9.1	18.2
Total	360	16.9	19.3	63.8	55.3	35.4	9.3

I.4 Kategoritë Profesionale të Pu.Pa-ve

Profesionet e vlerësuara të Punëkërkuesve të Papunë, referuar aftësive dhe kualifikimeve që ata kanë fituar gjatë arsimimit apo përvojës së punës, janë klasifikuar sipas Listës Kombëtare të Profesioneve⁶.

Të dhënat për profesionet e Punëkërkuesve të Papunë, mbledhen sipas **10** grupeve.

Grupet kryesore në klasifikimin e Profesioneve:

1. Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtues ekzekutiv;
2. Specialistë me arsim të lartë;
3. Teknikë dhe specialistë në zbatim;
4. Nëpunës të thjeshtë;
5. Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve;
6. Punonjës të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit;
7. Zejtarë, zanatçinj dhe profesione të lidhura me to;
8. Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve;
9. Punëtorë të ndihmës (profesione elementare);
10. Forcat e armatosura.

Secili grup ka nëngrupe të mëdha (total 38) që i përkasin fushës së aktivitetit.

⁶ Miratuar me VKM nr.514 dt. 20.09.2017




Fig.22 Pu.Pa. sipas kategorive kryesore profesionale

Emërtimet e Kategorive Profesionale	Numri i Pu.Pa						
	Total	Femra	ndihmë ekonomike	romë	egjiptianë	aftësi e kufizuar	emigrant
1. Menaxherë	0.47	0.39	0.18	0.03	0.05	0.40	0.73
2. Specialistë me arsim të lartë	7.44	9.17	2.52	0.54	1.65	4.84	7.28
- të shkencave të fizikës, matematikës dhe inxhinierisë	1.13	0.91	0.44	0.00	0.15	0.67	2.18
- të shëndetësisë	0.67	0.89	0.27	0.00	0.15	0.20	0.00
- të mësimdhënies	2.63	3.92	0.82	0.06	0.48	1.48	1.21
- të administrimit dhe të biznesit	0.34	0.39	0.05	0.00	0.02	0.27	0.49
- të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit	0.42	0.31	0.06	0.06	0.07	0.20	0.73
- të fushës ligjore shoqërore dhe kulturore	2.24	2.74	0.88	0.42	0.77	2.02	2.67
3. Teknikë dhe specialistë të mesëm	3.04	3.03	1.48	0.38	0.73	2.29	2.91
- bashkëpunëtorë profesionistë në inxhinieri dhe shkencë	0.72	0.31	0.43	0.06	0.17	0.61	0.97
- asistentë të specializuar të shëndetësisë	0.53	0.80	0.22	0.00	0.12	0.07	0.49
- asistentë në administrim dhe biznes	0.72	0.78	0.34	0.00	0.10	0.61	0.49
- specialist ligjor, shoqëror, kulturor, të rendit	0.51	0.64	0.37	0.22	0.24	0.34	0.00
- teknikë të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit	0.55	0.49	0.13	0.10	0.10	0.67	0.97
4. Nëpunës	1.63	2.01	0.62	0.35	0.51	3.63	2.67
- nëpunës dhe mbështetës zyresh	0.26	0.44	0.06	0.00	0.05	0.27	0.24
- nëpunës të shërbimit të klientëve	0.66	0.78	0.26	0.16	0.19	2.82	0.73
- nëpunës për llogaritje dhe regjistrimit të materialeve	0.35	0.34	0.23	0.10	0.17	0.20	0.49
- nëpunës të tjerë mbështetës në zyrë	0.36	0.45	0.08	0.10	0.10	0.34	1.21
5. Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	27.41	41.55	28.43	25.67	25.88	20.11	10.68
- të shërbimeve personale dhe të mbrojtjes	11.53	15.77	12.34	5.62	8.25	8.27	1.70
- punonjës shitje	4.17	5.83	3.69	7.76	3.78	3.36	3.16
- punonjës të kujdesit personal	11.00	19.88	11.79	12.16	13.27	7.60	4.85
- punonjës të shërbimeve dhe mbrojtjes	0.71	0.06	0.61	0.13	0.58	0.87	0.97
6. Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe të peshkimit	2.86	2.92	5.08	3.26	2.54	3.63	1.94
- punonjës të kualifikuar të bujqësisë për treg	2.28	2.51	3.96	2.04	1.91	3.36	1.21
- punonjës të kualifikuar të pyjeve, peshkimit, gjahtarë, vendosës kurthesh	0.27	0.06	0.61	1.12	0.39	0.20	0.49
- prodhues të produkteve bujqësore, blegtorale dhe të peshkimit	0.31	0.36	0.52	0.10	0.24	0.07	0.24
7. Zejtarë zanatçinjtë dhe profesione të lidhura me to	18.75	11.36	26.31	17.98	21.88	13.05	29.85
- punonjës të ndërtimit	6.41	1.03	17.27	9.23	14.02	5.51	19.90
- punonjës të punimit të metaleve dhe montimit të makinerive	2.24	0.15	1.69	1.50	2.11	1.41	4.13

- punonjës të prodhimit artizanal dhe shtypshk. etj.	1.17	1.57	1.12	4.18	0.77	0.54	1.21
- punonjës në profesionet e elektro-teknologjisë	1.07	0.10	0.48	0.13	0.36	0.74	2.18
- punonjës të përpunimit të ushqimit, drurit, tekstileve etj.	7.85	8.51	5.74	2.94	4.62	4.84	2.43
8. Punonjës në Industri	5.22	3.46	5.22	2.71	3.95	3.03	6.07
- punonjës të minierave dhe përpunimit të metaleve	2.84	3.41	3.13	2.23	3.27	1.55	2.43
- montues	0.06	0.04	0.04	0.00	0.02	0.07	0.00
- drejtues automjeti dhe punëtor të makinave industriale	2.31	0.01	2.05	0.48	0.65	1.41	3.64
9. Profesione Elementare	28.53	21.44	26.95	41.67	42.00	39.00	35.19
- punëtor shërbimi dhe ndihmës	4.36	2.71	2.12	4.50	4.60	8.14	3.88
- punëtor të bujqësisë pyjeve dhe të peshkimit	1.04	0.96	1.10	0.35	0.24	2.22	2.18
- punëtor në miniera, ndërtim, industri e transport	16.63	10.83	17.30	26.95	30.53	20.04	22.82
- ndihmës në përgatitjen e ushqimit	0.75	1.10	0.40	0.16	0.31	0.81	2.43
- punëtor për shitje dhe shërbime të ndryshme në rrugë	0.03	0.02	0.03	0.03	0.10	0.07	0.00
- mbledhës pletrash dhe punëtor të shërbimeve të tjera elementare	5.72	5.84	6.00	9.67	6.22	7.73	3.88
10. Forcat e Armatosura	0.05	0.10	0.03	0.03	0.00	0.00	0.00
- Oficer të forcave të armatosura	0.04	0.03	0.01	0.03	0.00	0.00	0.00
- Nënoficerë dhe të tjerë në forcat e armatosura	0.01	0.07	0.02	0.00	0.00	0.00	0.00
Pa profesion	4.60	4.57	3.19	7.38	0.82	10.02	2.67

Tab.9 Pu.Pa. sipas Kategorive Profesionale



Rajonet	Menaxherë	Specialistë me arsim të lartë	Teknikë dhe specialistë të mesëm	Nëpunës	Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve	Zejtare zanatçinjtë dhe profesione	Punonjës në Industri	Profesione Elementare	Forcat e Armatosura	Pa profesion
Berat	0.3	9.6	2.4	2.1	14.3	1.7	30.0	6.7	32.4	0.0	0.4
Dibër	0.3	8.6	2.3	0.5	35.2	0.4	23.2	9.0	19.4	0.0	1.3
Durrës	0.4	7.3	2.9	3.6	32.6	2.8	16.4	9.8	22.8	0.0	1.4
Elbasan	0.1	6.5	2.3	0.5	21.8	3.3	20.7	4.0	38.8	0.0	2.0
Fier	0.1	7.6	2.9	1.1	26.2	5.6	20.4	5.8	15.6	0.0	14.6
Gjirokastrë	0.2	5.6	2.6	1.4	27.1	1.5	17.7	3.4	37.7	0.0	2.7
Korçë	0.2	7.9	2.7	1.0	26.4	2.5	16.4	4.2	35.3	0.0	3.5
Kukës	1.3	6.0	2.2	1.4	33.0	1.5	22.3	5.2	26.0	0.2	1.1
Lezhë	0.1	4.8	1.4	0.8	26.1	1.8	13.1	3.7	47.8	0.0	0.5
Shkodër	0.4	7.7	4.7	2.4	24.3	10.3	23.6	6.5	18.7	0.0	1.2
Tiranë	0.8	8.4	4.2	2.1	27.0	1.9	16.2	3.1	27.0	0.1	9.2
Vlorë	0.7	8.9	3.9	2.2	29.1	1.3	11.6	4.4	31.0	0.1	6.9



Tab.10 Pu.Pa. të regjistruar sipas Profesioneve dhe Rajoneve

Kapitulli II

POLITIKA E PUNËSIMIT



Punëdhënësit janë një tjetër klient shumë i rëndësishëm i Zyrave të Punësimit. Bazuar në ligjin Nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, burimi i të dhënave për punëkërkuesit dhe punëdhënësit është sistemi i informacionit të institucioneve të varësisë ose nëpërmjet studimeve specifike apo anketimeve që kanë të bëjnë me dinamikat dhe tendencat e tregut të punës apo të segmenteve të tij.

Gjatë vitit 2022 rezultonte se rreth **37%** e bizneseve aktive të regjistruar në DPT ishin klientë të Zyrave të Punësimit.

Pra, të dhënat statistikore për punëdhënësit sigurohen nëpërmjet Regjistrimit të Punëdhënësit në Zyrat e Punësimit.

Regjistri i Punëdhënësit përditësohet bazuar në:

- ✓ Vizitat e specialistëve të ZP në subjekte;
- ✓ Kontakteve me përfaqësuesit e bizneseve në mjediset e Zyrës së Punës;
- ✓ Marrjen e informacionit nëpërmjet telefonit, e-mail-it etj.

Informacioni statistikor në këtë kapitull ka të bëjë me:

- ✓ Karakteristikat e përgjithshme të biznesit;
- ✓ Vendet e lira të shpallura në Zyrat e Punësimit;
- ✓ Lejet e punës, Vërtetimet e punësimit dhe Certifikatat e regjistrimit për të huajt.

II.1 Karakteristikat e përgjithshme të biznesit

Në Tr.2 2021 AKPA nisi përdorimin e sistemit të përmirësuar të shërbimeve të punësimit. Ky proces nisi me transferimin e databazës së punëdhënëseve nga sistemi i vjetër në sistemin e përmirësuar në muajin Prill 2021. Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2021 specialistët e ZP vijuan me procesin e rikontaktimit me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe hartimit të Planit të Trajtimit të Punëdhënësit (PTP) për çdo punëdhënëse që dakordësonte marrjen e shërbimeve që përcaktohen në këtë plan.

Sipas të dhënave në fund të vitit 2022, në Zyrat e Punës rezultojnë të regjistruara **46,380** subjekte, prej tyre **3,539** subjekte ose **8%** janë regjistruar për herë të parë gjatë vitit 2022.



Fig.23 Subjektet e reja të regjistruara në ZP për 2022

Gjithashtu në sistemin e përmirësuar të shërbimeve të punësimit në regjistrin e punëdhënësit u përfshinë edhe subjektet private të licencuara për ofrimin e kurseve të formimit profesional.

Gjatë 2022 në Zyrat e Punës janë regjistruar 735 subjekte të licencuar për ofrimin e kurseve profesionale ose 2% të totalit të subjekteve klientë të ZP.




Fig.24 Subjektet e regjistruara si punëdhënës në ZP të licencuar për kurset e formimit profesional

Sipas llojit të pronësisë rreth 96 % e subjekteve të regjistruara si punëdhënës janë me kapital privat, 2% janë subjekte me kapital publik dhe 2% janë OJF.




Fig.25 Subjektet e regjistruara si punëdhënës në ZP sipas tipit të pronësisë

Rajonet	OJF	Privat	Publik
Berat	0.4	95.5	4.1
Dibër	0.5	94.9	4.6
Durrës	0.9	97.1	2.0
Elbasan	0.8	97.4	1.8
Fier	0.4	97.5	2.1
Gjirokastrë	0.8	94.1	5.1
Korçë	1.2	95.6	3.2
Kukës	1.2	93.3	5.5
Lezhë	0.5	96.9	2.6
Shkodër	1.9	95.3	2.7
Tiranë	3.7	95.4	0.9
Vlorë	0.9	96.9	2.2
Total	1.6	96.1	2.3

Tab.11 Subjektet e regjistruara në ZP (në %) sipas Rajoneve dhe tipit të pronësisë

Prej **46,380** subjekteve që rezultojnë të regjistruara si punëdhënës në fund të vitit 2022, rreth 65% e tyre përqëndrohen në Rajonet Tiranë, Fier, Vlorë dhe Durrës.




Fig.26 Subjektet e regjistruara në ZP, sipas Rajoneve

Duke ju referuar aktiviteteve ekonomike ku operojnë subjektet private, dominon Tregtia me shumicë dhe me pakicë (28%); Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (28%), Industria Përpunuese (14%), Akomodimi dhe shërbimi ushqimor (13%) dhe Ndërtimi (6%).




Fig.27 Subjektet e regjistruara në ZP, sipas Aktiviteteve ekonomike

Tab.12 Subjektet të regjistruara në ZP sipas Aktiviteteve ekonomike dhe Rajoneve

Lloji i aktivitetit	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
Bujqësia, Pyjet, Peshkimi	3.7	1.3	12.7	3.0	34.4	0.5	2.0	1.2	8.1	5.9	12.2	14.8
Industria Nxjerrëse	8.2	25.1	3.0	6.4	11.0	0.2	1.4	8.2	2.3	1.1	28.1	5.0
Industria Përpunuese	4.5	1.9	13.0	14.2	13.2	1.8	5.3	0.4	3.7	6.0	29.4	6.7
Energjia elektrike, gaz, avull ajër i kondicionuar	2.2	0.5	1.5	2.4	1.0	2.4	2.9	1.9	10.7	23.6	26.0	24.8
Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	4.0	3.1	5.3	4.4	4.4	2.7	5.8	0.4	6.7	32.4	28.0	2.7
Ndërtimi	2.6	3.0	16.6	4.1	10.1	0.6	2.4	1.4	1.1	2.0	47.1	8.9
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	4.2	2.4	9.9	7.6	16.6	2.9	7.3	1.9	2.3	1.8	35.6	7.5
Transporti dhe magazinimi	2.2	1.8	11.1	4.5	13.2	1.4	2.9	0.8	28.4	2.2	25.5	5.9
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	6.2	2.9	11.4	7.1	11.7	2.3	9.8	1.8	1.5	1.5	33.8	10.0
Informacioni dhe komunikacioni	1.6	0.5	4.0	2.0	2.9	2.7	1.0	0.7	22.7	8.3	43.6	10.0
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	1.0	0.5	1.5	1.3	1.1	3.5	1.0	1.6	12.4	37.4	15.2	23.4
Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	0.6	0.0	6.6	0.8	1.3	0.6	0.9	0.4	14.0	19.0	36.2	19.5
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	1.5	1.2	5.7	2.2	3.9	3.4	2.1	0.4	6.0	16.4	36.1	21.1
Shërbime administrative dhe mbështetëse	2.1	0.8	13.1	2.4	3.4	1.9	2.0	1.0	2.6	6.1	55.8	8.8
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	5.5	1.9	3.5	6.7	6.2	3.9	7.0	1.9	7.0	9.4	37.1	10.2
Arsimi	2.7	1.3	7.7	5.3	5.1	0.7	3.6	1.5	6.9	0.7	55.8	8.6
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	2.9	2.6	6.8	5.8	9.8	1.9	1.0	1.5	3.0	5.7	49.9	9.0
Arte, argëtim dhe çlodhje	0.9	1.1	2.1	2.3	5.0	1.6	1.6	7.7	15.7	16.9	28.0	17.1
Aktivitetet të tjera shërbimi	3.9	1.7	8.6	5.0	9.6	8.3	5.0	2.4	2.7	6.2	39.4	7.1
Aktivitetet të familjeve si punëdhënës	0.0	0.8	2.4	0.4	3.2	1.2	2.8	0.0	28.3	14.6	37.7	8.5
Aktivitetet të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare	0.0	0.0	0.0	1.1	0.0	3.8	1.1	2.2	16.7	54.8	9.1	11.3
Total	3.7	2.2	9.5	6.5	11.3	2.6	5.1	1.5	5.8	7.3	34.3	10.2

II.2 Vendet e Lira të shpallura në Zyrat e Punësimit

Të dhënat për Vendet e Lira të shpallura në Zyrat e Punësimit, sigurohen nga Regjistri i Vendeve të Lira të Punës në Sistemin e Shërbimeve të Punësimit.

Regjistri i Vendeve të Lira përditësohet bazuar në:

- ✓ Vizitat e specialistëve në subjekte;
- ✓ Kontaktet me përfaqësuesit e bizneseve në mjediset e Zyrës së Punës;
- ✓ Informacioni i marrë me telefon, e-mail etj.

Gjatë vitit 2022, rezultoi se **4,982** subjekte shpallën **39,815** vende të lira pune. Prej totalit, të VLP-ve të shpallura 23% janë siguruar nga vizitat e specialistëve në subjekte, 34% nga vetë raportimet e subjekteve, 14% nga e-albania dhe 29% e VLP-ve janë siguruar në mënyra të tjera. Gjithashtu, prej totalit të VLP-ve të shpallura 30,650 vende të lira ose 77% e totalit janë poste të reja dhe 9,165 ose 23% e totalit janë zëvendësime.

Rajonet me produktivitetin më të lartë të vizitave në ndërmarrje, për sa i përket finalizimit me marrjen e vendit të lirë, janë Elbasani, Shkodra, Korça dhe Lezha.




Fig.28 Numri i subjekteve që kanë shpallur VLP dhe numri i VLP-ve të shpallura sipas Rajoneve

Në nivel kombëtar rezultoi se raporti i VLP-ve të shpallura për një subjekt ishte 8. Rajonet me raportin më të lartë se niveli kombëtar ishin Fieri, Durrësi, Elbasani dhe Tirana përkatësisht me 13.1, 11.4, 9.1 dhe 8.7.

Raport më të ulët se niveli kombëtar kishin Rajoni i Kukësit dhe Gjirokastrës përkatësisht me raportet 4.1 dhe 4.4. Rajoni i Kukësit dhe Gjirokastrës karakterizohen nga një numër i ulët i subjekteve të regjistruar në Zyrat e Punësimit, gjithsesi kjo vjen si rrjedhojë e faktit se numri i subjekteve private që operojnë në këto rajone është i ulët.




Fig.29 Vendet e lira të punës të shpallura, sipas Aktiviteteve ekonomike

Grafiku i mësipërm paraqet se në cilat aktivitete ekonomike janë gjeneruar më shumë vende të reja pune. Rreth 76% e vendeve të reja të punës janë në Industrinë Përpunuese, Tregti, Akomodim dhe shërbim ushqimor si edhe Ndërtim.

Grafiku në vijim paraqet VLP-të e shpallura gjatë vitit 2022, detajuar në poste të reja dhe zëvendësimeve sipas Rajoneve.




Fig.30 Vendet e lira të punës sipas Rajoneve

Krahasuar me vitin 2021, konstatohet një rritje prej 59% e VLP-ve të shpallura. Nisja e përdorimit të sistemit të përmirësuar të shërbimeve të punësimit e orientoi punën e specialistëve me punëdhënësin jo vetëm në mbledhjen e ofertave por edhe në përditësimin e të dhënave të punëdhënësve sipas skedës së kërkuar në sistemin e ri.




Fig.31 Mënyra e sigurimit të VLP-ve




Fig.32 Mënyra e sigurimit të VLP-ve sipas Rajoneve




Fig.33 Vendet e lira të regjistruara në ZP sipas Aktivitete ekonomike




Fig.34 Vendet e lira të punës sipas Kategorive Profesionale




Fig.35 Vendet e lira të punës krahasuar me numrin e Pu.Pa.(Stoku 2022) sipas Rajoneve

Mospërputhja e ofertës dhe kërkesës për punë është e gjithanshme. Numri i ofertave për punë është 52% e numrit të punëkërkuësve të papunë të regjistruar në të gjitha ZP, por nëse në rajonet Tiranë dhe Fier kjo shifër shkon përkatësisht 86% dhe 62%, në qarqet Kukës dhe Dibër varion nga (9-18)% të Totalit të Pu.Pa., të regjistruar. Në rajonin e Durrësit numri i VLP-ve të shpallura rezultoi më i lartë se numri i Pu.Pa., të regjistruar.

Krahasuar me fundin e vitit 2021 numri i VLP –ve të shpallura gjatë vitit 2022 rezultojnë me rënie në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit, dhe paraqiten me rritje në tregti si edhe në Akomodim dhe shërbim ushqimor.

II.3 Lejet e Punës, Vërtetimet e Punësimit dhe Certifikatat e Regjistrimit në Punë, për të Huajt.

Numri i të huajve që imigrojnë drejt Shqipërisë për motive punësimi vjen gjithnjë e në rritje. Në zbatim të detyrimeve ligjore⁷, një nga aktivitetet që kryhet nga AKPA, me anë të rrjetit të saj të zyrave të punësimit është pajisja me dokumente pune për kategoritë e shtetasve të huaj, përfitues. Imigrantët, që shërbejnë nga sportelet e migracionit janë ata shtetas të huaj që kanë hyrë rregullisht në Republikën e Shqipërisë dhe që para fillimit të punës pajisen me një nga këto dokumente:

A. LEJE PUNE

Me Leje Pune pajisen të gjithë shtetasit e huaj që përjashtohen nga marrja e Vërtetimit të Deklarimit për Punësim si dhe Certifikatës së Regjistrimit në Punë.

Janë 16 tipe Leje Pune për kategori të ndryshme për Punëmarrës

1. Tipi A/P Punëmarrës;
2. Tipi A/PS Punonjës stinor;
3. Tipi A/TN punonjës i transferuar brenda ndërmarrjes;
4. Tipi A/S për student;
5. Tipi A/NK Punonjës ndërkufitar;
6. Tipi A/FP Formim Profesional,
7. Tipi A/SHV Shërbim vullnetar;
8. Tipi A/AF Anëtar i Familjes;
9. Tipi A/KL Punonjës me kualifikim të lartë;
10. Tipi A/SP për sportist;
11. Tipi A/PSh punonjës shtëpiak;
12. Tipi C/ për raste të veçanta;
13. Tipi C/ShK Shërbime kontraktuese), Punëdhënës
14. Tipi B/I Investitor) dhe të Vetëpunësuar
15. Tipi B/VP i vetëpunësuar)
16. Tipi D (Leja e Përhershme kur kanë plotësuar kriteret)

B. VËRTETIM DEKLARIMI PËR PUNËSIM:

- Shtetasit e BE;
- Shtetasit e Zonës Schengen;
- Shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- Shtetasit e Republikës së Kosovës;
- Shtetasit e Republikës së Serbisë me përkatësi etnike shqiptare.

C. CERTIFIKATË REGJISTRIMI NË PUNË

Ky dokument lëshohet referuar nenit 73 të Ligjit për të Huajt, sipas të cilit për disa kategori punonjësish si p.sh. të huaj që punojnë si lektorë në seminare të përbashkëta, artist, staf teknik etj.

⁷ Ligji Nr.108/2013 dt. 28/03/2013 "Për të Huajt", dhe VKM Nr. 66-70 dhe 74-85 dt. 12.02.2014.

Për vitin 2022, janë **8,305** shtetas të huaj (ose **3,271** më shumë se një vit më parë) të pajisur me Leje Pune dhe Vërtetime Deklarimi për Punësim. Pjesa më e madhe e Lejeve dhe Vërtetimeve (rreth **41%**) janë në rajonin e Tiranës, **19%** janë dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA, **17%** nga Rajoni Durrës dhe **7%** nga Rajoni Fier.




Fig.36 Numri i të huajve të punësuar në Shqipëri sipas Rajoneve




Fig.37 Numri i të huajve të punësuar në Shqipëri sipas statusit në punësim

Nga **8,305** shtetasit e huaj të punësuar për 2022, rezulton se **6,411** janë pajisur me Leje Pune dhe **1,894** të tjerë me Vërtetime Deklarimi për Punësim.

Tab.13 Lejet e Punës për të huajt sipas Rajoneve dhe Tipit të lejes

Qarqet	LEJE PUNE Gjithsej	punëmarrës															investitor (B/I)	të vetpunësuar (P/V/P)
		gjithsej	A/AF	A/FP	A/KL	A/NK	A/P	A/PS	A/PSH	A/S	A/SHV	A/SP	A/TN	C	C/SHK	d		
Berat	60	60	0	0	7	0	52	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0
Dibër	8	7	0	0	0	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Durrës	1234	1193	0	0	0	0	1166	0	0	1	0	1	0	25	0	0	0	41
Elbasan	276	272	0	1	0	0	270	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	4
Fier	437	435	0	0	2	0	423	0	0	0	0	10	0	0	0	0	0	2
Gjirokastrë	8	8	0	0	0	0	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korçë	11	9	0	0	0	0	7	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0	2
Kukës	7	7	0	0	0	0	7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Lezhë	151	151	0	0	0	0	142	0	1	0	0	8	0	0	0	0	0	0
Shkodër	170	165	0	0	0	0	165	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5
Tiranë	2550	2235	0	0	8	0	2113	0	47	0	6	30	5	26	0	0	0	315
Vlorë	324	266	0	0	0	0	264	0	0	0	0	0	0	0	2	0	0	58
DPAKPA	1175	1175	0	0	0	0	1128	0	0	0	0	0	0	9	13	25	0	0
Totali	6411	5983	0	1	17	0	5752	0	48	1	7	52	5	60	15	25	0	428

Për të vlerësuar aktivitetet ekonomike që “importojnë” punonjës të huaj më shumë shih grafikun në vijim.




Fig.38 Shpërndarja e Lejeve të Punës për të huajt, sipas aktiviteteve ekonomike




Fig.39 Numri i punonjësve të huaj të pajisur me Leje pune sipas shtetësisë

Tab.14 Vërtetimet e punësimit sipas shtetësisë

Lejet e punës sipas shtetësisë

Lloji i shtetësisë	Gjithsej	Femra	Sipas statusit të punësimit			Lloji i shtetësisë	Gjithsej	Femra	Sipas statusit të punësimit		
			Punëmarrës	investitorë	Te vetëpunësuar				Punëmarrës	investitorë	Te vetëpunësuar
Italiane	626	113	370	10	246	Turke	1087	85	1000	0	87
Kosovare	221	29	180	0	41	Bangladeshi	887	3	882	0	5
Polake	165	16	155	0	10	Të tjerë:	825	251	696	0	129
Rumune	124	25	119	0	5	Egjiptiane	731	29	690	0	41
Angleze	112	18	101	0	11	Indiane	681	86	665	0	16
Maqedonase	93	7	86	0	7	Nepali	525	178	525	0	0
Gjermane	80	15	64	0	16	Filipineze	445	303	441	0	4
Amerikane	76	27	46	0	30	Siriane	361	20	334	0	27
të tjera	46	13	37	0	9	Pakistaneze	158	5	150	0	8
Greke	36	4	22	1	13	Ukrainase	126	65	113	0	13
Austriake	35	5	32	0	3	Gjeorgjiane	111	47	108	0	3
Hungareze	34	3	29	0	5	Kineze	108	29	97	0	11
Spanjolle	33	3	31	0	2	Ruse	98	49	59	0	39
Franceze	32	4	23	0	9	Indoneziane	63	44	62	0	1
Kroate	30	6	30	0	0	Bjelloruse	55	24	36	0	19
Hollandeze	25	1	22	0	3	Nigeriane	49	7	49	0	0
Të tjerë	126	24	104	0	22	Të tjerë	101	30	76	0	25
Total	1894	313	1451	11	432	Total	6411	1255	5983	0	428

Gjatë vitit 2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s dhe Zyrat e Punës janë pajisur me Certifikatë Regjistrimi në Punë **316** shtetas të huaj.




Fig.40 Numri i punonjësve të huaj të pajisur me Certifikata sipas afatit




Fig.41 Numri i punonjësve të huaj të pajisur me Certifikata sipas shtetësisë




Fig.42 Numri i punonjësve të huaj të pajisur me Certifikata sipas kategorive profesionale

Kapitulli III

SHËRBIMET DHE POLITIKAT E NDJEKURA TË TREGUT TË PUNËS



Një pjesë shumë e rëndësishme e Informacionit të Tregut të Punës, janë të dhënat e siguruar nga monitorimi i politikave të punësimit që zbaton AKPA.

III.1 Treguesit e monitorueshëm për vitin 2022

Karta e treguesve të monitorueshëm përcakton arritjet vjetore të indikatorëve më të rëndësishëm që masin nivelin e shërbimit të Zyrës së Punës ndaj klientëve të saj: punëkërkesit dhe punëdhënësit. Treguesit kryesor të performancës si punësimet, përfshirja në programet aktive të tregut të punës, numri i VLP-ve të shpallura dhe rritja e numrit të punëdhënësve klientë të Zyrës së Punës, detajohen edhe në tregues të tjerë që i referohen prioritizimit të grupeve vulnerabel në zbatim të treguesve të strategjive përkatëse dhe indikatorëve të tjerë strategjik.

Treguesit e monitorueshëm për vitin 2022 janë përcaktuar duke marrë në konsideratë të gjitha aktivitetet e nevojshme që Zyrat e Punësimit duhet të ndjekin në kuadër të riformatimit strukturor dhe IT, indikatorët e përcaktuar në strategjitë e ndryshme, realizimin e treguesve për vitin 2021 dhe fondet në dispozicion për zbatimin e PATP-ve gjatë 2022.

Disa nga indikatorët që përbëjnë Kartën e Treguesve të Monitorueshëm për vitin 2022 janë:

- Punësimi i **25,000** Pu.Pa-ve;
- Mbështetja me programe të nxitjes së punësimit të **1,765** Pu.Pa-ve;
- Orientimi i **9,000** Pu.Pa-ve në kurse për formim profesional;
- Regjistrimi për herë të parë në Zyrat e Punësimit i **1,500** subjekteve aktive;
- Sigurimi dhe shpallja e **26,000** vendeve të lira pune; etj.

Me qëllim koordinimin e punës për realizimin e treguesve të formimit profesional, edhe gjatë vitit 2022 u hartua dhe Karta e Treguesve të Monitorueshëm për DROFPP-të. Seti i indikatorëve që përmban kjo kartë u ndërthur me Kartën e Treguesve të Monitorueshëm të Zyrrave të Punës, duke unifikuar objektivat e përbashkët.

Tabela në vijim paraqet realizimin e tre indikatorëve kryesorë të performancës: punësimin, vendet e lira të shpallura dhe ndjekjen e kurseve të formimit profesional.

Tab.15 Treguesit kryesorë të performancës dhe realizimi i tyre sipas Rajoneve

Rajonet	PU.PA të punësuar			VLP të shpallura			Dërguar në kurse Formimi Profesional		
	Plani vjetor	Realizimi	Në %	Plani vjetor	Realizimi	Në %	Plani vjetor	Realizimi	Në %
Berat	1276	1182	93%	1076	1262	117%	141	164	116%
Dibër	780	1014	130%	644	878	136%	311	399	128%
Durrës	3390	3648	108%	3911	6494	166%	1127	1243	110%
Elbasan	1503	1590	106%	1959	3172	162%	1319	799	61%
Fier	2248	2737	122%	2904	4245	146%	837	774	92%
Gjirokastrë	905	945	104%	831	1128	136%	584	662	113%
Korçë	1981	2105	106%	1680	2416	144%	808	738	91%
Kukës	866	953	110%	477	597	125%	219	232	106%
Lezhë	899	968	108%	821	1441	176%	197	259	131%
Shkodër	1738	1872	108%	1737	2043	118%	723	845	117%

Tiranë	6857	7104	104%	7587	13538	178%	1839	2538	138%
Vlorë	2557	2690	105%	2373	2601	110%	895	760	85%
Total	25000	26808	107%	26000	39815	153%	9000	9413	105%

Zbatimi i aktiviteteve në fushën e Shërbimeve të Ndërmjetësimit, synon direkt përputhjen e ofertës dhe kërkesës për punë. Janë përthithur dhe shpallur **39,815** vende të lira pune nga Zyrat e Punësimit, ose 59% më shumë se një vit më parë. Gjatë periudhës janar- dhjetor 2022 janë punësuar 26,808 punëkërkues të papunë ose 11% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Ky tregues është realizuar në masën 107% të objektivit vjetor 2022.

Gjithashtu, prioritet pati riintegrimi në tregun e punës i përfituesve të Ndihmës Ekonomike. Për këtë arsye në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 822, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të NE”, u hartua dhe nënshkrua Urdhri i Përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në të gjithë rajonet u ngritën komisionet rajonale, të cilët vlerësuan, referuan për punësim dhe integrim social anëtarët në moshë aktive pune. Këto komisione kishin përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoritë Rajonale të Punësimit dhe Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në Bashki.

Pranë Zyrave të Punësimit u referuan nga SHSSH 16,529 skeda. Ndërkohë u paraqitën pranë zyrave të punësimit 10,840 persona apo 65% e personave të referuar në total. Rezulton se 1 në 3 persona të paraqitur janë ndërmjetësuar për punësim dhe janë referuar për pjesëmarrje në program nxitje punësimi apo në formim profesional. Konkretisht janë punësuar 1,785 Pu.Pa., kanë marrë pjesë në programet e nxitjes së punësimit 692 Pu.Pa dhe 813 të tjerë kanë filluar një kurs të formimit profesional. Pjesa tjetër e të referuarve ose kanë refuzuar ofertat ose kanë qenë të paafte për punë.

Për shkak të pengesave të hasura në punësimin e tyre, Pu.Pa nga kategoria e aftësisë së kufizuar dhe romë/ egjiptianëve rritën në mënyrë të konsiderueshme numrin e pjesëmarrjes së tyre në programet aktive të tregut të punës (nxitje punësimi dhe formim profesional) krahasuar me një vit më parë, ndërkohë ndërmjetësimi rezultoi një indikator tepër i vështirë për t’u arritur në këto kategori.

Tab.16 Niveli i plotësimit të vendeve të lira sipas Rajoneve

Rajonet	Vende të lira të shpallura			Niveli i plotësimit
	Gjithsej	Prej tyre te reja	Prej tyre nga vizitat	
Berat	1262	737	148	90%
Dibër	878	847	25	72%
Durrës	6494	4838	278	67%
Elbasan	3172	3117	1780	31%
Fier	4245	3920	1286	50%
Gjirokastrë	1128	1080	71	55%
Korçë	2416	2126	1029	49%
Kukës	597	554	107	69%
Lezhë	1441	1391	566	36%
Shkodër	2043	1166	1013	56%
Tiranë	13538	8818	1880	42%
Vlorë	2601	2056	885	71%
Total	39815	30650	9068	52%

III.2 Punëkërkesit e Papunë të punësuar

Gjatë vitit 2022 Zyrat e Punës kanë mundësuar punësimin e **28,984** Punëkërkesve të Papunë (përfshirë punësimin nëpërmjet PNP-ve) nga **25,768** që kishim një vit më parë.

Prej këtyre punësimeve, **12,363** janë realizuar me ndërmjetësim direkt nga ZP, **2,176** punësime janë realizuar nëpërmjet zbatimit të PNP-ve të reja, ndërsa pjesa tjetër janë Punëkërkes të Papunë që kanë gjetur vetë punë pas trajtimit me shërbime nga ZP. Rritja e punësimeve me 12% krahasuar me një vit më parë, erdhi si pasojë e rritjes së ndjeshme të numrit të ndërmjetësimeve dhe punësimit nëpërmjet PNP-ve.




Fig.43 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim+ G.J.P.V) 2021/2022 sipas Rajoneve

Në të gjitha rajonet numri i punësimeve ka qenë më i lartë se një vit më parë.

A. GJINIA

Në fund të vitit 2022, rezulton se nga **40,620** Punëkërkuese të Papuna Gra të regjistruara gjithsej, kanë arritur të punësohen **13,044** prej tyre, ose **2%** më shumë se një vit më parë.

Ndërsa nga **28,743** Pu.Pa., Kryefamiljarë, kanë arritur të punësohen vetëm **7,898** prej tyre ose **3%** më shumë se një vit më parë.



Fig.44 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim+ G.J.P.V), sipas Gjinisë dhe statusit familjar

Punësimi i grave varet shumë nga spektri i aktivitetit ekonomik në rajon.

Konkretisht, në periudhat e mëparshme numri më i lartë i VLP-ve të shpallura në rajonin e Dibrës përqëndrohej në industrinë nxjerrëse dhe ndërtim. Si rezultat edhe numri i grave të punësuar ndaj totalit rezultonte i ulët (nën 40%). Gjatë 2022 vihen re ndryshime të konsiderueshme në zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në këtë rajon. Numri më i lartë i VLP-ve të shpallura gjatë 2022 u gjenerua nga industria përpunuese, akomodimi dhe shërbimi ushqimor si edhe tregtia duke rritur numrin e grave të punësuar në nivelin 49% të Totalit.

Në rajonet si Fieri, Durrësi, dhe Elbasani ka një zhvillim industria përpunuese sidomos e konfeksioneve, tregtia, akomodimi dhe shërbimi ushqimor duke u karakterizuar nga një nivel i lartë i punësimit të grave në këto aktivitete ekonomike.

Gjatë vitit 2022 edhe rajoni i Tiranës ka pësuar ndryshime në peshën e VLP-ve të gjeneruara sipas aktiviteteve ekonomike. Numri më i lartë i VLP-ve të shpallura u gjenerua nga akomodimi dhe shërbimi ushqimor, industria përpunuese, tregtia dhe ndërtimi. Krahësuar me një vit më parë rezulton një rënie e numrit të VLP-ve të shpallura në industrinë përpunuese dhe rritje e tyre në ndërtim, akomodim dhe shërbim ushqimor duke sjellë në këtë mënyrë dhe uljen e numrit të grave të punësuar në këtë rajon në nivelin 40% të Totalit.




Fig.45 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim+ GJ.P.V) sipas Gjinisë dhe Rajoneve

B. GRUPMOSHA

Po t'i referohemi moshës, vihet re që **31%** e Totalit të Pu.Pa. të punësuar janë të rinj deri në 29 vjeç. Ndërsa shanset më të vogla në punësim duket që i kanë grupmoshat e mëdha mbi 50 vjeç, të cilat zënë vetëm **14%** të Totalit të të punësuarve, pavarësisht se përbëjnë rreth 34% të punëkërkuesve të papunë të regjistruar.




Fig.46 Pu.Pa të punësuar (Ndërmjetësim + G.J.P.V) sipas Grupmoshave

Bizneset ku punësohen më shumë të rinjtë janë: industria përpunuese, akomodimi dhe shërbimi ushqimor dhe tregtia. Kjo vihet re edhe nga tabela në vijim, ku qarqet Vlorë, Durrës, Korçë dhe Kukës, ku janë të zhvilluara këto degë, kanë nivelin më të lartë të punësueshmërisë për këtë grupmoshë.

Ndërsa moshat mbi 45 vjeç, punësohen kryesisht në profesione elementare, gratë në degët e industrisë përpunuese ndërsa burrat në ndërtim dhe miniera.

Tab.17 Pu.Pa., të punësuar (Ndërmjetësim + G.J.P.V) sipas Grupmoshave dhe Rajoneve

Rajonet	15 - 19 vjeç	20 - 24 vjeç	25 - 29 vjeç	30 - 34 vjeç	35 - 39 vjeç	40 - 44 vjeç	45 - 50 vjeç	mbi 50 vjeç
Berat	97	144	155	169	124	116	127	250
Dibër	32	105	143	171	172	151	138	102
Durrës	263	552	579	486	443	382	398	545
Elbasan	42	193	229	229	193	176	196	332
Fier	79	277	375	407	347	304	327	621
Gjirokastrë	46	157	114	150	117	104	97	160
Korçë	37	233	461	479	405	296	134	60
Kukës	20	157	160	94	118	116	117	171
Lezhë	63	141	127	113	114	126	105	179
Shkodër	37	138	244	304	308	260	277	304
Tiranë	347	574	872	948	1139	1436	968	820
Vlorë	226	481	513	423	353	324	198	172
Total	1289	3152	3972	3973	3833	3791	3082	3716

C. NIVELI ARSIMOR

Niveli arsimor i ulët i Pu.Pa-ve të regjistruar pranë Zyrave tona të Punësimit është një pengesë serioze në punësimin e tyre. Punëkërkuessit e papunë me arsim deri në 9 vjeçar, përbëjnë **42%** të Totalit të Pu.Pa-ve të regjistruar, ndërkohë **17%** e ofertave të punës janë për specialist me arsim të lartë, teknik të mesëm dhe nëpunës, **28%** janë për zanatçinjtë dhe **15%** për punonjësit e industrisë.




Fig.47 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim + GJ.P.V) sipas Nivelit arsimor

Tab.18 Pu.Pa. të punësuar sipas Rajoneve dhe Nivelit arsimor

Rajonet	Deri në 9 vjeçar	Gjinnaz	Mesme prof.	Universitare
Berat	483	316	162	221
Dibër	430	407	54	123
Durrës	1396	1072	591	589
Elbasan	756	422	115	297
Fier	1167	1016	255	299
Gjirokastrë	317	397	44	187
Korçë	1277	540	204	84
Kukës	319	379	36	219
Lezhë	399	367	54	148
Shkodër	828	733	146	165
Tiranë	2558	1384	1249	1913
Vlorë	1305	900	286	199
Total	11235	7933	3196	4444




Fig.48 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim + GJ.P.V) 2021/2022 sipas Nivelit arsimor

D. GRUPET E VEÇANTA

Pu.Pa., që iu përkasin grupeve të veçanta, kanë prioritet në përfshirjen në të gjitha politikat aktive shtetërore që zbaton AKPA.

Punësimi i tyre vazhdon të mbetet një sfidë për shërbimet publike të punësimit në Shqipëri, për shkak të specifikave të tyre dhe problematikave sociale që shpesh i shoqërojnë (shih grafikun në vijim).




Fig.49 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim + G.J.P.V) nga Grupet e veçanta 2021/2022

Tab.19 Pu.Pa. të punësuar (Ndërmjetësim+ G.J.P.V) sipas Gjinisë dhe Grupeve të veçanta

Emërtimi	Pu.Pa të punësuar Total	Pagesë papunësie	Ndihmë ekonomike	Afatgjatë	Romë/ Egjiptian	Aftësi të kufizuar	Emigrantë të kthyer
Total	26808	893	1785	4125	497	18	2
Femra	13044	489	902	1980	228	1	1
Meshkuj	13764	404	883	2145	269	17	1

Individët Pu.Pa., të punësuar përfitues nga skemat e mbështetjes me të ardhura, (pagesë papunësie dhe ndihmë ekonomike), përbëjnë vetëm **10%** të Totalit.

Nëse përfituesit e pagesës së papunësisë janë kryesisht të moshave mbi 30 vjeç dhe me arsim jo më pak se të mesëm, përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike janë kryesisht me arsim deri 9-vjeçar dhe të mesëm, dhe i përkasin të gjitha grupmoshave.

Shpesh Pu.Pa në ndihmë ekonomike janë edhe afatgjatë, ndaj këto grupe kanë të njëjtat karakteristika.

Tab.20 Pu.Pa. Të punësuar (Ndërmjetësim + G.J.P.V) sipas Grupeve të veçanta dhe Rajoneve

Rajonet	Pu.Pa të punësuar gjithsej	Pagesë papunësie	Ndihmë ekonomike	Afatgjatë	Romë/ Egjiptian	Aftësi të kufizuar	Emigrantë të kthyer
Berat	1182	128	22	235	88	2	2
Dibër	1014	9	206	194	0	8	0
Durrës	3648	44	29	556	81	1	0
Elbasan	1590	86	220	331	71	0	0
Fier	2737	114	50	925	17	4	0
Gjirokastrë	945	26	21	312	25	1	0
Korçë	2105	56	198	17	74	1	0
Kukës	953	19	291	425	2	0	0
Lezhë	968	45	58	191	8	0	0
Shkodër	1872	43	155	220	6	0	0
Tiranë	7104	220	430	714	78	1	0
Vlorë	2690	103	105	5	47	0	0
Total	26808	893	1785	4125	497	18	2

III.3 Të dhëna për pjesëmarrësit në Programet e Nxitjes së Punësimit

Programet aktive të Tregut të Punës përdoren në të gjithë botën si një nga instrumentet kryesore për trajtimin e problemit të papunësisë. Ashtu si shumica e vendeve evropiane, që nga viti 1999, Shqipëria zbaton një sërë politikash aktive për të “korrigjuar” defektet e Tregut të Punës që reflektohen në papunësi.

Në zbatim të Programit të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për mbështetjen e punëkërkuësve të papunë me programet aktive të Nxitjes së Punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive vuri në zbatim paketën ligjore sipas VKM-ve të miratuara si më poshtë:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.17, datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, i ndryshuar,
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 29.4.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet Vetëpunësimit”,
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 535, datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet”,
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 608, datë 29.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19”, i ndryshuar.

Programet e nxitjes së punësimit përfshirë dhe VKM-në Nr. 608, datë 29.07.2020, janë konceptuar në formë të tillë që përveç ndihmës që mund të kenë bizneset në situatën e vështirë të pandemisë, të adresojnë dhe nevojat e kategorive të disavantazhuara të punëkërkuësve të papunë.

Gjatë vitit 2022 u vunë në zbatim të gjithë programet sipas VKM-ve të sipërpërmendura.

Për sa i përket politikave aktive të tregut të punës, programet e reja të nxitjes së punësimit janë zhvilluar mbi qasjen e përmirësimit të nevojave të gjeneruara në bazë të analizave.




Fig.50 Dinamika e Fondit të Nxitjes së Punësimit, sipas Viteve (milion/lekë)

Tab.21 Të dhëna për programet e nxitjes së punësimit të zbatuara gjatë 2022

VKM	Numri i projekteve	Numri i punëkërkuessve të papunë	Fondi i konfirmuar për vitin buxhetor (në lekë)
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	266	523	43,881,595
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	150	338	35,366,947
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	229	929	59,201,995
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	9	20	1,769,204
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	106	515	69,152,176
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	163	466	35,480,789
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	69	1267	144,548,212
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	286	286	58,793,065
TOTALI	1,278	4,344	448,193,983

Krahasuar me vitin 2013, kemi trembëdhjetëfishim të përfituesve nga këto programe si subjekte (nga **91 projekte** në **1,278 subjekte**) dhe pesëfishim të përfituesve si Punëkërkuess të Papunë (nga **960 Pu.Pa** në **4,344 Pu.Pa**).

A. SUBJEKTET PËRFITUESE

Për periudhën janar-dhjetor 2022 nga zbatimi i programeve të nxitjes kanë përfituar **1,278** subjekte dhe **4,344** individë, nga të cilët **477** subjekte dhe **1,531** individë janë aplikime të vitit të 2021 (të cilët kanë vijuar të jenë përfitues edhe në vitin 2022).

Tab.22 Të dhëna për pjesëmarrësit në programet e nxitjes së punësimit sipas Rajoneve dhe Gjinisë

Rajonet	PU.PA përfitues	
	Gjithsej	Femra
Berat	237	153
Diber	166	116
Durrës	549	351
Elbasan	426	302
Fier	416	212
Gjirokastrë	389	252
Korçë	182	103
Kukës	131	88
Lezhe	121	87
Shkodër	644	291
Tiranë	759	412
Vlorë	324	206
Totali	4344	2573

Nga totali i subjekteve përfituese (të reja + të mbartura), **17%** e tyre e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Tregti me shumicë dhe pakicë, dhe Riparim automjesh, **17%** në Aktivitete të tjera shërbimi, **15%** në Akomodim dhe Shërbim ushqimor dhe **12%** në Industrinë Përpunuese.




Fig.51 Subjektet përfituese të programeve të reja sipas aktiviteteve ekonomike.

Gjatë vitit 2022, në programet e reja të PNP u përfshinë **801** subjekte dhe **2,813** punëkërkues të papunë. Rreth **54%** e subjekteve u përfshinë në programet e VKM Nr. 17, ndërsa **10%** e punëkërkuesve të papunë përfitues morën pjesë në programet e VKM Nr. 608. Rreth **30%** e subjekteve pjesëmarrëse ishin subjekte të çelura dhe mbështetura me programin e vetëpunësimit.

Numri më i lartë i subjekteve që aplikuan për pjesëmarrje në VKM Nr. 17 (punësimi dhe formimi nëpërmjet punës), ishte në aktivitetet ekonomike:

- Tregti;
- Akomodim dhe shërbim ushqimor;
- Industri Përpunuese.

Praktikat Profesionale u zhvilluan më tepër në subjekte të cilat kanë si aktivitet ekonomik shërbimet administrative dhe mbështetëse, shëndetësi dhe aktivitetet e mbrojtjes sociale.

Subjektet pjesëmarrëse në VKM Nr. 608 paraqiten më së shumti në industrinë përpunuese, akomodimin dhe shërbimin ushqimor, ndërtim dhe tregti.

Në programin “Punë Publike në Komunitet” janë përfshirë subjekte dhe OJF me aktivitet ekonomik akomodimin dhe shërbimin ushqimor, aktivitete të organizatave dhe organizmave eksteritoriale, dhe aktivitete shërbimesh të tjera.

Përfituesit e programit “Vetëpunësimi” u përqëndruan në aktivitete ekonomike si: tregtia, aktivitetet e tjera të shërbimit, akomodimi dhe shërbimi ushqimor, arte, argëtim dhe çlodhje.




Fig.52 Subjektet përfituese sipas VKM-ve dhe aktiviteteve ekonomike

B. PU.PA - PËRFITUES

Nga zbatimi i Programeve të nxitjes së punësimit për vitin 2022, janë punësuar, trajnuar nëpërmjet punës dhe kanë kryer praktikat profesionale rreth **4,834** Punëkërkuës të Papunë.




Fig.53 Total Pu.Pa. përfitues sipas VKM-ve

Rreth **23%** e pjesëmarrësve në programe paraqiten në VKM-në Nr. 608, **41%** e pjesëmarrësve në VKM-në Nr. 17, **29%** e pjesëmarrësve në VKM-në Nr. 535 dhe **7%** e pjesëmarrësve në VKM-në Nr. 348.

Kategoritë si gratë, pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe romë/ egjiptianët janë përfshirë më tepër në programin e VKM Nr. 535 dhe duke vijuar me programet e VKM-së Nr. 17. Punëkërkuësit e papunë nga aftësia e kufizuar kanë përfituar më tepër nga programi i punësimit dhe praktikave të punës, pjesë të VKM-së Nr. 17 (86% e totalit).




Fig.54 Total Pu.Pa. përfitues sipas Grupmoshës




Fig.55 Total Pu.Pa. përfitues sipas Nivelit arsimor

Pu.Pa. pjesëmarrës në PNP, të moshës deri në 29 vjeç, përbëjnë **41%** të Totalit, **929** prej tyre janë studentë të sapodiplomuar, të cilët kanë ndjekur praktikat profesionale në **229** subjekte ku pjesa më e madhe janë institucione të administratës publike, të arsimit, të shëndetësisë, banka etj.

Tab.23 Të dhëna për pjesëmarrësit në PNP sipas Programeve dhe Rajoneve

Rajonet	Pu.Pa pjesëmarrës sipas programeve								
	Gjithsej	V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	V.K.M 17 (Programi 2 Formimi Nëpërmjet Punës)	V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat E Punës)	V.K.M 608 (Programi 4 Mujor)	V.K.M 608 (Programi 8 Mujor)	V.K.M 608 (Programi 12 Mujor/ Informaliteti)	V.K.M 535 (Punët Në Komunitet)	V.K.M 348 (Programi I Vetëpunësimit)
Berat	237	28	47	50	12	6	25	67	2
Dibër	166	15	11	80	0	0	0	48	12
Durrës	549	53	112	84	0	171	30	74	25
Elbasan	426	48	0	115	0	37	90	121	15
Fier	416	14	5	56	1	32	120	174	14
Gjirokastrë	389	63	79	46	0	31	54	106	10
Korçë	182	23	0	82	1	1	7	61	7
Kukës	131	9	15	58	0	0	0	38	11
Lezhë	121	42	14	56	0	0	0	0	9
Shkodër	644	87	0	148	0	155	103	75	76
Tiranë	759	72	0	52	2	76	35	434	88
Vlorë	324	69	55	102	4	6	2	69	17
Totali	4344	523	338	929	20	515	466	1267	286

Numrin më të lartë të përfituesve e kanë rajonet Tiranë, Durrës dhe Shkodër përkatësisht me 17.4%, 12.7% dhe 14.8% të totalit të përfituesve. Në rajonin e Tiranës dhe Durrësit kjo shpjegohet me numrin më të lartë të punëkërkuësve dhe punëdhënësve të regjistruar në databazën e AKPA, ndërsa në rajonin e Shkodrës është shfaqur një interes më i lartë nga ana e subjekteve për të marrë pjesë në këto programe.

Ndërkohë rezulton se rajonet Elbasan, Fier dhe Korçë kanë raportin më të lartë të pjesëmarrësve pu.pa. për numër subjektsh përfituese.

Në rajonet e mësipërme spektri i aktiviteteve ekonomike është më i gjerë. Përveç subjekteve fasonë, industrisë përpunuese dhe të fushës së Tregtisë, bie në sy pjesëmarrja e subjekteve të aktiviteteve të Akomodimit dhe Shërbimit Ushqimor dhe Aktiviteteve të tjera të Shërbimeve.

Tab.24 Pu.Pa., përfitues nga Programet e nxitjes së punësimit sipas Grupeve të veçanta

VKM	TOTAL	pagesë papunësie	ndihmë ekonomike	romë/ egjiptianë	aftësi e kufizuar	emigrantë të kthyer
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	523	7	32	20	31	4
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	338	2	20	7	1	0
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	929	17	66	7	9	0
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	20	2	0	2	0	0
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	515	39	10	5	2	0
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	466	4	18	7	0	0
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	1267	104	542	247	4	9
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	286	2	4	9	1	4
TOTAL	4344	177	692	304	48	17

III.4 Të dhëna për pjesëmarrësit në Programet e Formimit Profesional

Programi i Formimit Profesional, si pjesë e politikave shtetërore aktive në fushën e punësimit, zbatohet nga AKPA, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Ofruesve të Formimit Profesional Publik. Ato ofrojnë kurse të ndryshme të formimit profesional (formim, riformim dhe riaftësim profesional), për fitimin e kualifikimeve të nevojshme profesionale për t'iu përshtatur kërkesave të Tregut të punës.

Drejtoritë Rajonale të Ofruesve të Formimit Profesional Publik, (DROFPP) janë institucione ku ofrohen trajnime afatshkurtra në profesione të kërkuara nga tregu i punës.

A. OFRUESIT PUBLIK TE FORMIMIT PROFESIONAL

Në vendin tonë zhvillojnë aktivitetin e tyre 10 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional Publik në qarqet; Tiranë (2), Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë, Qendra Lëvizëse për të gjithë rrethet e zonës Verilindore (Kukës, Dibër, Pukë, Mat, Bulqizë Has Tropojë) si dhe Qendra Shumëfunksionale Kamëz (11 institucione në total).

Qendrat Publike të Formimit Profesional, ofrojnë kurse në Nivel Kombëtar dhe kurse në Nivel Ofruesi. Nëse kurset e Nivelit Kombëtar janë unike për të gjitha qendrat në vend, kurset në Nivel Ofruesi, janë kurse specifike që ofrohen nga qendrat profesionale në funksion të kërkesave që kanë bizneset lokale etj.




Fig.56 Numri i kursantëve sipas DROFPP-ve

Përgjithësisht kurset janë kualifikime afatshkurtra dhe shërbejnë për përvetësimin e njohurive e kualifikimeve të lidhura me nevojat tregut të punës dhe kërkesat e bizneseve në nivel lokal dhe kombëtar. Në përfundim të kurseve, kursantët pajisen me Certifikatë.


Për të gjithë punëkërkuarit e papunë, ofrimi i kurseve të formimit në këto Qendra është pa pagesë.

B. STRUKTURA E KURSANTËVE

Nga **14,917** kursantë të regjistruar gjatë vitit 2022, në Qendrat Publike të Formimit Profesional, rreth 63% e kursantëve ishin punëkërkuar të papunë të referuar nga zyrat e punësimit, 24% ishin kursantë të punësuar dhe vetëpunësuar dhe pjesa tjetër përbëhet nga të papunët jo klientë të ZP, të burgosurit dhe studentët.

Në periudhën janar-dhjetor 2022 kanë ndjekur kurset e formimit profesional **9,398** punëkërkuar të papunë ose rreth **12%** e totalit të punëkërkuarve të papunë të regjistruar në Zyrat e Punës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i pjesëmarrësve në kurset e formimit rezulton të jetë 42% më i lartë se realizimi i vitit 2021.

Fig.57 Struktura e kursantëve në DROFPP



Tab.25 Struktura e kursantëve që përfituan pa pagesë kurse pranë DROFPP-ve

DROFPP	Pa pagesë (të regjistruar në ZP)					Të burgosur
	Pu-Pa	romë/ egjiptian	aftësi e kufizuar	afatgjatë	ndihma ekonomike	
Durrës	1312	11	1	60	45	121
Elbasan	762	67	46	1	193	69
Fier	889	67	14	135	84	113
Gjirokastrë	722	0	0	9	4	0
Korçë	717	7	1	20	10	20
Lëvizëse	932	23	0	273	242	0
Tirana 1	1349	36	7	65	73	32
Tirana 4	1191	44	8	94	100	0
Shkodër	739	0	5	59	46	0
Vlorë	738	0	1	70	16	270
Kamëz	47	0	0	0	0	0
	9398	255	83	786	768	625

Tab.26 Struktura e kursantëve që përfituan me pagesë kurse pranë DROFPP-ve

DROFPP	Të punësuar	Të Papunë me pagesë	Të tjerë
Durrës	601	109	9
Elbasan	481	118	11
Fier	195		
Gjirokastrë	200	6	3
Korçë	152		
Lëvizëse	216	25	
Tirana 1	552	363	47
Tirana 4	655	124	1
Shkodër	97		157
Vlorë	342	24	334
Kamëz	69	3	
Total	3560	772	562




Fig.58 Numri i kursantëve në DROFPP sipas llojit të kurseve

Referuar kurseve të profesioneve, më të frekuentuarit, në raport me totalin e pjesëmarrësve, janë: Kuzhinë (**11%**), Instalues dhe riparues të rrjetit elektrik (**8%**), Parukeri (**7%**), Manikyr – Pedikyr (**7%**), Hidraulik (**6%**) dhe Berber (**4%**).

Gjatë 2022, numri i kursantëve që kanë ndjekur kurset e gjuhëve të huaja ka pësuar rënie krahasuar me një vit më parë. Kurset e gjuhës angleze, italiane dhe gjermane janë ndjekur nga 793 kursante ose 5% e Totalit nga 8% që ishte një vit më parë.

Përveç të Papunëve në Qendrat Publike të Formimit Profesional, ndjekin kurset (kurse suplementare) edhe individë të Punësuar, Të burgosur (kurse trajnimi gjatë periudhës së kryerjes së dënimit)⁸ si dhe nxënës/studentë, pjesa më e madhe e të cilëve ndjekin kurset e gjuhëve të huaja apo përdorim kompjuteri.

Tab.27 Të dhëna për kursantët që kanë ndjekur kurset e formimit profesional në DROFPP

DROFPP-të	Te regjistruar	femra	të papunë me pagesë	Punëkërkes të papunë	të punësuar	të tjerë	të certifikuar	prej tyre femra
Durrës	2152	1024	109	1312	601	9	990	465
Elbasan	1441	554	118	762	481	11	619	223
Fier	1197	400		889	195		620	232
Gjirokastrë	931	340	6	722	200	3	711	269
Korçë	889	369		717	152		407	160
Lëvizëse	1173	614	25	932	216		812	443
Tirana 1	2343	1184	363	1349	552	47	1540	809
Tirana 4	1971	910	124	1191	655	1	1046	504
Shkodër	836	458		739	97	157	595	313
Vlorë	1531	748	24	738	342	334	970	476
Kamëz	453	162	3	47	69		405	134
Total	14917	6763	772	9398	3560	562	8715	4028

Tab.28 Të dhëna për Pu.Pa. të trajnuar sipas DROFPP-ve dhe Grupeve të veçanta

DROFPP-të	Gjithsej	nga pagesa	nga ndihma	afatgjatë	romë/ Egjiptian	afësi e kufizuar	emigrant ë të kthyer
Durrës	1312	5	45	60	11	1	1
Elbasan	762	8	193	1	67	46	0
Fier	889	3	84	135	67	14	0
Gjirokastrë	722	5	4	9	0	0	0
Korçë	717	3	10	20	7	1	0
Lëvizëse	932	4	242	273	23	0	0
Tirana 1	1349	5	73	65	36	7	6
Tirana 4	1191	5	100	94	44	8	1
Shkodër	739	2	46	59	0	5	0
Vlorë	738	1	16	70	0	1	0
Kamëz	47	0	0	0	0	0	0
Total	9398	41	813	786	255	83	8

⁸Sipas marrëveshjes nr.1366 të korrikut të 2009 midis M.P.Ç.S.SH.B dhe Ministrisë së Drejtësisë

Prej totalit **14,917** kursantë që janë regjistruar gjatë vitit 2022, **8,715** prej tyre e kanë përfunduar kursin po gjatë këtij vitit ndërkohë që pjesa tjetër referuar periudhës së regjistrimit dhe kohëzgjatjes së kursit do ta përfundojë atë gjatë vitit 2023.

Ndërkohë prej totalit të **8,715** kursantëve të cilët kanë nisur dhe përfunduar kurset e formimit profesional gjatë vitit 2022 rreth **83.8%** prej tyre janë certifikuar.

Për sa i përket treguesve të formimit profesional të përcaktuar në Kartën e performancës 2022, treguesi “totali i Pu.Pa-ve pjesëmarrës në formim profesional” është realizuar në masën 104%, ndërsa realizimi i treguesve për grupet e veçanta është tepër pozitiv.

Tab.29 Të dhëna për kursantët e trajnuar dhe certifikuar sipas DROFPP-ve

Emërtimi i DROFPP	Totali i të regjistruarve në kurse	Prej tyre		Totali i të certifikuarve	Prej tyre	
		Femra	Pu.Pa		Femra	Pu.Pa
Durrës	2152	1024	1312	990	496	601
Elbasan	1441	554	762	619	223	313
Fier	1197	400	889	620	232	505
Gjirokastrë	931	340	722	711	269	567
Korçë	889	369	717	407	160	311
Lëvizëse	1173	614	932	812	454	601
Nr.1	2343	1184	1349	1540	809	937
Nr.4	1971	910	1191	1046	504	613
Shkodër	836	458	739	595	313	517
Vlorë	1531	748	738	970	476	447
Kamëz	453	162	47	405	134	35
TOTAL 1 Kurset e reja 2022	14917	6763	9398	8715	4070	5447
TOTAL 2 Kurset e reja+ të mbartura	15658	7191	9873	9351	4434	5835




Fig.59 Të dhëna për Pu.Pa. të trajnuar nga Grupet e veçanta




Fig.60 Të trajnuar sipas grupmoshave dhe llojit të kurseve

Tab.30 Të dhëna për pjesëmarrësit në kurset e FP sipas statusit dhe llojit të kursit

EMËRTIMI I KURSIT	Të trajnuar total	Prej tyre Femra	Të papunë me pagesë	PU.PA	Të punësuar	Të burgosur	Të tjerë	Të certifikuar	Prej tyre Femra	Prej tyre Pu.Pa.
Kuzhinë	1711	1027	53	1098	443	107	10	899	562	576
Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik	1248	14	43	593	498	106	8	679	10	309
Parukeri	1022	991	19	894	103		6	595	577	517
Manikyr Pedikyr	972	970	55	746	163		8	552	550	426
Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike	888	5	33	524	305	26		463	4	254
Aftësi Digjitale	804	310	1	422	36		345	760	287	382
Berber	629	14	19	497	84	29		336	6	276
Saldim	494	1	1	246	164	83		281		134
Rrobaqëpsi	473	409	10	385	30	48		247	234	233
Kujdestar social	422	363	31	257	134			241	203	143
Gjuhë e huaj , anglisht	399	169	68	22	94	146	69	278	119	21
Estetikë	375	374	23	293	58	1		208	208	170
Sipërmarrje dhe menaxhim i biznesit të vogël	349	226	12	265	72			193	125	144
Sipërmarrje dhe zhvillimi i planit të biznesit	325	163		325				292	149	292
Graphic Design	292	166	10	231	51			123	66	93
Servis motori në automjetet e lehta	276	1	4	174	98			161		94
Servis xhenerik në automjetet e lehta	215	9	6	159	48		2	130		93
Udhërrëfim turistik	215	98	2	161	52			118	60	82
Gjuhë e huaj , italisht	204	143	66		36	16	86	131	95	
Kujdestar fëmijësh	202	200	17	119	66			129	129	75
Gjuhe e huaj , gjermanisht	190	134	107	5	43	24	11	124	94	3
Pasticier	174	144	11	115	48			100	83	60
Sekretari	172	156	12	106	54			74	67	50
Punime muratimi dhe suvatimi	169	2	4	79	86			138	2	56
Servis elektroauto ne automjetet e lehta	163		14	123	26			68		50
Web Design	160	93	13	118	29			124	72	92
Mobiliери	155	1	4	92	59			83		44
Kujdestari për të moshuar	141	108	16	65	60			100	73	45
Shërbime mikpritje hotelerie	124	59	6	98	20			77	34	62
Instalim dhe mirëmbajtje e sistemeve ngrohëse-ftohëse	120	2	19	33	61		7	63		13
Riparime elektroshtepiake	109		11	41	23	34		57		23
Administrator ndërtesash	106	10	10	34	62			82	10	26
Të tjera	1619	401	72	1078	454	5	10	809	209	609
Totali	14917	6763	772	9398	3560	625	562	8715	4028	5447




Fig.61 Pjesëmarrësit në kurset e Formimit Profesional sipas llojit të kurseve




Fig.62 Pjesëmarrësit sipas nivelit arsimor dhe llojit të kurseve

Të rinjtë pjesëmarrës në kurset profesionale pranë Qendrave të Formimit Profesional Publik, përbejnë **47%** të Totalit të pjesëmarrësve. Ajo që duhet theksuar është që në pjesën më të madhe të kurseve pjesëmarrja e të rinjve ngelet mbi **40%**.

Pjesëmarrësit me nivel arsimor të mesëm përbëjnë **61%** të Totalit të pjesëmarrësve.

Nëse i referohemi llojit të kurseve, shikojmë që përveç kurseve; Grafik Dizajn, Ueb Dizajn dhe Aftësi Digjitime (ku një pjesë të konsiderueshme e zënë pjesëmarrësit me arsim të lartë), në pjesën më të madhe të kurseve e tjera, arsimi i mesëm përbën mbi **50%** të pjesëmarrësve në çdo kurs.

Rezultatet e procesit të gjurmimit që u zhvillua në 2023 treguan se % e të punësuarve pas certifikimit në FP për të certifikuarit e vitit 2022 ishte **60.9%** nga **50.5%** që rezultoi një vit më parë.

C. IMPLEMENTIMI I KURSIT AFTËSI DIGJITALE

Prej vitit 2015 Shqipëria po zbaton politika specifike për digjitalizmin referuar Strategjisë Ndërsektoriale Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020 dhe në vijim të saj Strategjisë Ndërsektoriale Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026. Strategjia është e orientuar drejt vizionit të krijimit të një shoqërie të bazuar në njohuri dhe informacion, përmes konsolidimit të infrastrukturës digjitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike online dhe rritjen e transparencës së qeverisjes. Strategjia 2022-2026 bazohet mbi vizionin “shërbime digjitale gjithëpërfshirëse dhe pa kufi, për qytetarët dhe bizneset”.

Në këtë kuadër, AKPA nën mbështetjen e GIZ për herë të parë në 2022 nisi të zbatojë në të gjitha Qendrat e Formimit Profesional kursin “Aftësi Digjitale” me qëllim rritjen e aftësive të Pu.Pa-ve për integrimin e tyre në tregun e punës.

Gjatë 2022 rezultojnë 804 Pu.Pa të cilët morën pjesë në këtë trajnim në të gjitha qendrat.




Fig.63 Pjesëmarrësit në Kursin Aftësi Digjitale sipas DROFPP-ve

Pjesa më e madhe e përfituesve janë trajnuar në Qendrën Shumëfunksionale Kamëz, duke vijuar me qendrat e Tiranës dhe Shkodrës.

III.5 Të dhëna për pjesëmarrësit në Programin e Pagesës së Papunësisë

Programi i Pagesës së Papunësisë është pjesë e politikave shtetërore të punësimit, të cilat sigurojnë mbështetjen me të ardhura të të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës.

Ato synojnë të mbështesin financiarisht të gjithë punëkërkesit e papunë në rast papunësie për shkak të shkurtimit të vendit të punës, ndërprerjes së kontratës së punës, falimentimit të ndërmarrjes, zvogëlimit të aktivitetit etj., duke lehtësuar sadopak përpjekjet e tyre drejt punësimit.

Aktualisht këto shërbime kryhen në zbatim të ligjit të sigurimeve shoqërore dhe gjithashtu nën principin e respektimit të së drejtës së shtetasve rezidentë në Shqipëri për “Mbështetje me të ardhura të garantuara nga ligji për nxitjen e punësimit⁹”.

Pavarësisht se kontributet për sigurimin nga papunësia mblidhen nga sigurimet shoqërore, duke ndjekur shembullin e pjesës më të madhe të vendeve të Evropës, pagesa e papunësisë i është deleguar për zbatim Zyrrave të Punës (ZP).

Të drejtën për të përfituar e kanë të gjithë personat që, janë të siguruar në sigurimet shoqërore dhe për ta është kontribuar sigurim për papunësi jo më pak se 12 muaj, janë të vërtetuar nga ZP se janë të papunë dhe pranojnë të kualifikohen dhe rikualifikohen, nuk marrin përfitime të tjera nga ligji i Sigurimeve Shoqërore me përjashtim të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për këtë Program çdo vit merr pjesën e kryesore tek totali i buxhetit të AKPA.




Fig.64 Fondi i pagesës së papunësisë në Vite (milion Lekë)

Gjatë vitit 2022 u vu re një rënie e ndjeshme e numrit të përfituesve të pagesës së papunësisë nga **2,914** pu.pa përfitues që rezultojnë në janar 2022, ky numër u ul në **2,307** Pu.Pa. në muajin dhjetor 2022.

Në skemën e pagesës së papunësisë gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2022 kanë hyrë mesatarisht **418** përfitues çdo muaj, ku peshën specifike më të madhe e zënë personat që vijnë nga zvogëlimi i aktivitetit ose prishje e kontratave të punës. Si rezultat i mbarimit të afatit të trajtimit, nga skema e pagesës së papunësisë kanë dalë mesatarisht **468** përfitues çdo muaj.

⁹Neni 1, parag.2.

Bazuar në periudhën e përfitimit vëmë re se numri më i lartë vazhdon t'i përkasë periudhës së përfitimit prej 12 muaj. Kjo për dy arsye: periudha e kontributeve mbi 10 vjet dhe grupmosha mbi 55 vjeç për gratë dhe mbi 60 vjeç për burrat. Vërehet gjithashtu se këto dy grupmosha vazhdojnë të zënë dhe numrin më të madh të përfituesve të së ardhurës nga papunësia në total.

Gjatë muajit shkurt 2022 u miratua VKM Nr. 71 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit nga punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh”. Ky vendim përcaktonte përfitimin nga kategoria në fjalë, të 100% të vlerës së pagës minimale si edhe pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi gjatë periudhës shkurt- mars 2023 u regjistruan në zyrat e punësimit Mallakastër, Fier, Berat, Vlorë dhe Tiranë rreth **450** persona aplikantë. Prej totalit të aplikuesve rreth **435¹⁰** punëkërkues të papunë rezultuan përfitues.

Fondi i shpenzuar gjatë vitit 2022 në këtë program është **735.5** milion lekë ose **99.95%** e fondit të rishikuar.




Fig.65 Pu.Pa. të regjistruar në pagesë papunësie sipas Muajve




Fig.66 Pu.Pa. të regjistruar në pagesë papunësie sipas Periudhës së përfitimit

¹⁰ ky numër lidhet specifikisht me këtë program dhe nuk është i përfshirë në numrin e përfituesve të pagesës së papunësisë

Tab.31 Bilanci vjetor i skemës së pagesës së papunësisë

Shtesat për vitin 2022							Pakësim për vitin 2022						
Gjithsej			Arsyet e papunësisë				Gjithsej			Arsyet e largimit			
Gjithsej	Shtet	Privat	Reformat	Prishje /mbarim kontrata punësimi	Ristrukturim/privatizim ndërmarrjes	Arsye të tjera	Gjithsej	Shtet	Privat	Ndërmjetësuar për punë	Pjesëm.progr.nxitje punes.	Mbarojnë afatin e përfitimit	Arsye të tjera
5,010	1059	3,951	181	4,206	374	249	5,617	1,085	4,532	815	272	4,087	443




Fig.67 Pu.Pa të regjistruar në pagesë papunësie sipas Rajoneve dhe sektorit të ndërmarrjes





Fig.68 Pu.Pa të regjistruar në pagesë papunësie sipas Qarqeve dhe Gjinisë

Kapitulli IV

ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE DHE NJERËZORE



Performanca e politikave të punësimit në Tregun e Punës është e lidhur ngushtësisht me performancën e stafit të sistemit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) si dhe mirëmenaxhimin e buxhetit vjetor të saj.

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019, datë 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit” u miratua VKM Nr. 554 datë 31.7.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, e ndryshuar. Ky vendim krijon dhe përcakton:

- mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA);
- misionin e AKPA-s dhe fushat e përgjegjësiwe funksionale;
- institucionet administrative dhe ofruese të shërbimeve të punësimit, vetëpunësimit dhe formimit profesional.

Sipas VKM-së së sipërcituar, AKPA është përgjegjëse për zbatimin e politikave të punësimit dhe aftësive nëpërmjet menaxhimit të zyrave të punës dhe ofruesve të AFP-së, në nivel rajonal dhe vendor.

AKPA për vitin 2022 administroi dhe menaxhoi fonde për:

- ✓ Administratën Qendrore dhe Lokale;
- ✓ Programin e Nxitjes së Punësimit;
- ✓ Programin e Formimit Profesional;
- ✓ Programin e Pagesës së Papunësisë;
- ✓ Investime.

Tab.32 Fondi i AKPA-s sipas Programeve (Vite)

Aktiviteti	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Pagesë Papunësie	860	846	800	1000	536	350	532	968	986	736
Nxitje Punësimi	90	270.6	450	490	490	281	403	253	522	466
Formim Profesional	138.5	200	217	206	245	247	280	282	295	331
Administrata Qendrore dhe Lokale	305.8	370	323	335	330	275	359	364	395	444
Investime	5.9	26.4	36	127	77	76	53	41	38	67
Total	1400	1713	1826	2158	1678	1229	1627	1908	2236	2044

Tab.33 Realizimi i Treguesve të Buxhetit për 2022 (000/lekë)

	Viti buxhetor 2022			
	Plani i rishikuar	Fakt	diferenca	% e realizimit
Planifikim e Menaxhim (Drejtoria Qëndrore AKPA)	130,170	123,233	6,937	95%
Punësimi nga Drejtoritë Rajonale të Punësimit	313,535	306,299	7,236	98%
Nxitje Punësimi	466,000	452,222	13,778	97%
Pagesë Papunësie	735,533	735,515	18	100%
Formimi Profesional Publik	330,907	320,987	9,920	97%
Investime Buxhetore	67,000	65,195	1,805	97%
Totali i shpenzimeve AKPA	2,043,145	2,003,451	39,694	98%

Tab.34 Stafi i AKPA-s sipas Kategorive profesionale

KATEGORITË	Nr. punonjësve		DRAKPA		DROFPP		Drejtoria Qëndrore	
	Gjithsej	F	Gjithsej	F	Gjithsej	F	Gjithsej	F
Drejtues	87	55	58	36	11	5	18	14
Specialistë me arsim të lartë	347	276	230	179	78	62	39	35
Teknikë dhe specialistë në zbatim	1	0	1	0	0	0	0	0
Nëpunës të thjeshtë	3	3	1	1	2	2	0	0
Punëtorë	6	3	0	0	1	0	5	3
TOTAL	444	337	290	216	92	69	62	52




Fig.69 Stafi i AKPA (DRAKPA-t & DROFPP- të & Drejtoria Qëndrore) sipas Gjinisë

Për sa i përket arsimit, **98%** e të gjithë stafit janë me arsim të lartë, me një pagë mujore mbi **50 mijë Lekë**.




Fig.70 Shpërndarja e personelit të DRAKPA-ve dhe DROFPP- ve

Kapitulli V

ARSIMI I MESEËM PROFESIONAL



V.1 Të dhëna për regjistrimet e nxënësve për vitin shkollor 2022-2023

A. NXËNËS TË REGJISTRUAR

Në shkollat e mesme të arsimit profesional rezultojnë **15,042** nxënës të regjistruar për vitin shkollor 2022-2023. Sipas klasave, rreth **29%** e nxënësve ndjekin klasën e X, **25%** klasën e XI, **23%** klasën e XII dhe **23%** klasën e XIII.

Prej totalit të nxënësve të regjistruar rezultojnë:

16 % vajza
45 % nga zonat rurale
14 % në ndihmë ekonomike
5 % romë/egjiptian
1 % PAK




Fig.71 Numri i nxënësve të klasave të X të regjistruar në AP




Fig.72 Numri i nxënësve të regjistruar në AP sipas klasave

Numri i të regjistruarve në arsimin profesional është më i lartë në rajonet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër përkatësisht **36%, 14%, 10% dhe 9%** të Totalit.




Fig.73 Nxënës të regjistruar në AP sipas shkollave

Shkollat me numrin më të lartë të nxënësve të regjistruar janë: Shkolla Profesionale Bujqësore Kamëz, Shkolla Profesionale "Beqir Çela", Shkolla Teknike Elektrike "Gjergji Canco", Shkolla e Ndërtimit "Karl Gega", Shkolla e Mesme Teknologjike "Hysen Çela", Shkolla Hoteleri–Turizëm, Shkolla “Petro Sota” dhe Shkolla Teknologjike "Hamdi Bushati" të cilat kanë të regjistruar **51%** të nxënësve që ndjekin arsimin profesional.




Fig.74 Nxënës të regjistruar në AP sipas drejtimeve

Drejtimet me numrin më të lartë të nxënësve të regjistruar janë Hoteleri- Turizëm, Shërbime Mjetesh Transporti, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Elektroteknikë, Ekonomi-Biznes dhe Termohidraulikë. Këto drejtime ndiqen nga 74% e nxënësve të regjistruar në AP.




Fig.75 Nxënës të regjistruar në AP sipas profileve

Profilet më të frekuentuara rezultojnë Shërbime Elektroauto, Kuzhinë-Pastiçeri, Shërbime Mjetesh Transporti, Rrjete të Dhënash (pilot GIZ), Llogari, Tregti, Instalime Elektrike,

Programim dhe Mbështetje e Përdoruesve të TIK, të cilat ndiqen nga **42%** e nxënësve të profilizuar.

B. BURSAT

Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në arsimin profesional AKPA inicioi ndryshimet në VKM-në e bursave në funksion të rritjes së masës dhe kategorive përfituese, ndryshime të cilat tashmë janë miratuar.

VKM Nr. 666 datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe për përcaktimin e kriterëve për përcaktimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, përcakton se përfitojnë bursë: vajzat, nxënësit që janë me statusin e jetimit, të regjistruarit në drejtimet parësore, rom/egjiptianët, nxënës nga familjet me ndihmë ekonomike etj.

Prej Totalit të nxënësve të regjistruar në AP, rezulton se **4,237** ose **28%** prej tyre përfitojnë bursë. Rreth **88%** e nxënësve përfitues marrin bursë të plotë dhe pjesa tjetër bursë të pjesshme.




Fig.76 Niveli i përfitimit të bursave nga nxënësit e regjistruar në AP sipas Drejtimeve

C. PRAKTIKAT PROFESIONALE

Për vitin shkollor 2022-2023 shkollat e mesme të arsimit profesional kanë marrëveshje bashkëpunimi aktive me **2,278** biznese. Prej totalit, **1,730** biznese ofruan poste praktike ku zhvilluan praktikat profesionale **4,616** nxënës ose **64%** e Totalit të klasave të X dhe XI.

Shkollat “Hamdi Bushati”, “Hysen Çela”, “Beqir Çela” dhe “Bujqësore Kamëz” rezultojnë me numrin më të lartë të bizneseve partnere dhe nxënësve që zhvillojnë praktikat në këto biznese.




Fig.77 Numri i bizneseve partnere që kanë ofruar poste praktike sipas shkollave

Drejtimi	Biznese	Praktikantë
Bujqesi	29	233
Detari	1	15
Ekonomi-biznes	132	569
Elektroteknikë	66	172
Hoteleri-turizem	695	1335
Inxhinieri Informatike Software	72	87
Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë, gaz dhe ujë	1	30
Mekanike	124	318
Ndërtim	4	27
Perpunim druri	5	17
Sherbime kujdesi për të moshuar (pilot – GIZ)	1	33
Sherbime mjeteve transporti	430	736
Sherbime sociale dhe shëndetësore	22	300
Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	35	142
Teknologji ushqimore	31	140
Tekstil-konfeksione	9	74
Termohidraulike	59	241
Veterinari	14	147
Total	1730	4616

Tab.35 Numri i bizneseve partnere dhe nxënësve që zhvillojnë praktikën në biznes sipas Drejtimeve

Ç. KALUESHMËRIA

Në fund të vitit shkollor 2021-2022 u certifikuan **7,992** nxënës dhe **3,226** të tjerë u diplomuan.

Kalueshmëria për këtë vit shkollor në provimet e nivelit ishte **93%** ndërsa për maturën shtetërore ishte **89%**.




Fig.78 Niveli i kalueshmërisë sipas shkollave

V.2 Rezultatet e Gjurmimit

Gjatë 6 muorit të parë 2023, AKPA me mbështetjen e projektit Skills 4 Jobs ka zhvilluar procesin e gjurmimit në nivel kombëtar për të diplomuarit/certifikuarit e vitit shkollor 2021-2022 në shkollat e mesme profesionale.

Nga rezultatet paraprake rezulton se punësueshmëria e nxënësve pas diplomimit është 59.5 % (2% më tepër se një vit më parë) nëse përfshihen nxënësit që vazhdojnë studimet e larta dhe 77.4% nëse kjo kategori nuk përfshihet në përllogaritje.

Rezultatet e gjurmimit paraqitën rezultate pozitive për indikatorët më të rëndësishëm që u matën. Niveli i punësueshmërisë dhe niveli i pjesëmarrjes së të diplomuarve aktiv në tregun e punës shënuan rritje krahasuar me një vit më parë, duke ulur në mënyrë të konsiderueshme % e të diplomuarve të cilët nuk janë në arsim, formim ose punësim (NEET).

Punësueshmëria pas diplomimit për maturën 2021-2022 krahasuar me 2020-2021




Fig.75 Rezultatet e Gjurmimit për AP 2021-2022/ 2020-2021

**BULETINI VJETOR
I AGJENCISË KOMBËTARE
TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
PËR VITIN 2022**